

SELEFITË janë të pastër!

Salih bin AbdulAziz Alu Shejh



Selefizmi dhe kuptimi i të atribuarit në Rrugën e Selefite.



Autor: Shejh Salih bin AbdulAziz Alu Shejh

Burimi: (Shtjellim i shkëlqyer rreth dijës dhe praktikës në metodologjinë e Selefus-Salih, i shkëputur nga libri **“Këto janë konceptet tona”** të autorit, shkëlqesisë së tij, shejh Salih bin AbdulAziz Alu Shejh, ministër i çështjeve fetare, vakëfit, thirrjes dhe udhëzimit në Mbretërinë e Arabisë Saudite).

Muslimanët janë dy kategorish: pasues të gjeneratave të para-selefij dhe pasues të atyre të mëvonshëm-halefij.

Selefijë janë: pasuesit e brezave të parë të muslimanëve të vlefshëm (**Selefus-Salih**), ndërsahalefijë janë: pasuesit e koncepteve të muslimanëve të mëvonshëm, që ndryshe quhen edhe shpikës-bidatçinjë.

Kështu që, kushdo që nuk është i kënaqur me metodën e Selefus-Salih në dije, vepër, perceptim dhe fik’h, ai konsiderohet halefij, bidatçi.

Selefus-Salih janë brezat e artë të muslimanëve. Në krye të tyre janë shoqëruesit (**sahabët**) e të Dërguarit të Allahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, të cilët i lavdëroi All-llahu në Kur'an duke thënë:

“Muhamedi është i dërguar i All-llahut, e ata që janë me të (sahabët) janë të ashpër kundër jobesimtarëve, e të mëshirshëm ndërmjet tyre...” (Fet’h 29).

Ata, po ashtu, i lavdëroi edhe i Dërguari i All-llahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, duke thënë: **“Brezi më i mirë është brezi im, pastaj ata që vinë pas tyre, e më pas ata që vinë pas tyre”**.

Përveç kësaj, vazhduan fjalët e vet sahabëve dhe të pasuesve të tyre në të mirë për vlerën e tyre në tërësi dhe pasimit të shtigjeve të tyre.

Ka thënë Ibën Mes'udi, radijAll-llahu anhu: **“Ai i cili nga ju ndjek ndonjë rrugë, atëherë le të ndjek rrugën e shoqëruesve (sahabëve) të Muhamedit, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ngase ata kishin zemrat më të devotshme, ishin më të thelluarit në dituri, kishin më së paku fjalë të panevojshme, ishin më të fortit në udhëzim dhe në përgjithësi kishin gjendjen më të mirë. Grup që All-llahu e zgjodhi për ta shoqëruar të Dërguarin e Tij dhe për ta ngritur Fenë e Tij. Njihni virtytet e tyre! Pasoni ata në gjurmët e tyre! Ngase, ata me të vërtetë ishin në Udhëzimin e Drejtë”**.

Çështja e vlerës së tyre është e njëzëshme tek ehklus-suneti. Në mesin e tyre nuk ka kontestues që e konteston atë. E përderisa ata **(Selefus-Salih)** qëndrojnë në një pozitë të lart sikur kjo e tyre, atëherë nuk është habi që muslimani të jetë i privilegjuar kur i atribuohet udhëzimeve të tyre në të kuptuarit e Kur'an-it dhe Sunetit, në interpretimin e të dy këtyre, si dhe në të vepruarit me citatet e tyre.

Çdo grup i devijuar nga grupet e këtij ummeti, për pretendimet dhe orientimet e tyre argumentonin me ajete dhe hadithe, por në kundërshtim me kuptimin e selefit.

Ata u zgjeruan aq shumë në këtë sa që arritën ta akuzonin njëri-tjetrin me mosbesim, i ngatërruan citatet e Kur'an-it njërin më tjetrin, e gjithë kjo ndodhi si pasojë e kuptimit të tyre ndaj civateve sipas asaj që çdo grup pretendonte.

Kështu që çdo grup i devijuar filloi të deklaroi: **“Ne marrim nga Kur'ani e Suneti”**, e kjo ua pështjelloi pa masë gjërat njerëzve me perceptim të dobët e më dituri të pakët.

Shpëtimi nga këto propaganda dhe deklarata të devijuara, është vetëm në pasimin e rrugës së brezit më të mirë.

Atë që ata e kanë kuptuar nga citatet, ajo është e vërteta, e atë që ata nuk e kanë kuptuar dhe vepruar me të, assesi nuk mund të jetë nga e vërteta.

Kështu i pasuan në të mirë ata që e pranuan **(Fenë)** nga Sahabët e ndershëm – All-llahu qoftë i kënaqur me të gjithë- e që më pas, ata që i atribuoheshin metodologjisë së sahabëve në të kuptuarit e Kur'anit dhe Sunetit, në pranimin e asaj që është transmetuar nga ta drejtpërdrejt nga Pejgamberi, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, në mënjanimin e ideologjive dhe kuptimeve të shpikura, u bë që ai që kjo ishte metodologjia dhe rruga e tij të konsiderohej selefij, e ai që nuk ishte sipas kësaj, u bë që të konsiderohej halefij-bidatçi.

Pasi që të jetë vendosur në këtë mënyrë, atëherë çdo çështje prej çështjeve të diturisë nuk përjashtohet vetëm se të jetë nga njëra nga tri gjendjet:

01 - Të jetë që sahabët dhe pasuesit e tyre, të gjithë apo një pjesë e tyre, ta ketë thënë dhe vepruar atë çështje, e që njëkohësisht duke mos ekzistuar në mesin e tyre askush që e kundërshton atë.

02 - Të jetë që një pjesë e tyre (**sahabëve**) kanë vepruar me të e të cilët kanë qenë më shumë, ndërsa pjesa tjetër e tyre e kanë kundërshtuar atë.

03 - Që ajo çështje të mos jetë vepruar me të në mesin e tyre.

Pjesa e parë: Të jetë që gjithë sahabët kanë vepruar me të apo disa prej tyre por duke mos njohur kundërshtarë të saj në mesin e tyre. Kjo, padyshim, konsiderohet Sunneti që duhet pasuar, orientimi i kthjellët e i qartë, rruga e drejt dhe e çiltër që askujt nuk i lejohet ta kundërshtojë atë.

Shembujt në lidhje me këtë janë të shumtë dhe të njohur për tu përmendur, si në çështje të besimit ashtu edhe në çështjet e adhurimit praktik.

Pjesa e dytë: Të jetë që me atë çështje kanë vepruar një pjesë e sahabëve, e të cilët kanë qenë më shumë, ndërsa të tjerët e kanë kundërshtuar atë, kështu që ka dominuar shumica e sahabëve ndaj asaj që e ka zgjedhur ajo pakicë e tyre dhe kanë vepruar me atë që nuk kanë vepruar të tjerët (**pakica**).

Shatibiu në librin **“El-Muvafakat fi Usulish-Sheriah”** (3/57) në lidhje me obligueshmërinë e pasimit të shumicës së tyre thotë: **“Kjo që është ndryshe (nga pakica) është Sunneti që duhet ndjekur dhe rruga që duhet trasuar, ndërsa për atë që nuk është vepruar nga ta veçse pak, së pari duhet verifikuar atë dhe të vepruarit në përputhshmëri me të, duke këmbëngulur në atë që është më gjithëpërfshirëse dhe me e shumë, sepse vazhdimësia e të parëve për një vepër duke i kundërshtuar pakicën është: për shkak të ndonjë kuptimi sheriatik, e që ata patjetër në sajë të atij kuptimi janë përpjekur që të veprojnë me të, e përderisa është kështu, atëherë të vepruarit sipas pakicës konsiderohet kundërshtim i kuptimit të shumicës dhe pajtueshmërisë së vazhdueshme të tyre.”**

Pastaj, prapë, thotë (3/70-71): **“Për këtë arsye, vepruesi duhet të përkujdeset që vepra të jetë në përputhshmëri me të parët. Nuk duhet t'i lejojë vetës për të vepruar sipas pakicës, përveç se shumë rrallë, si: në rast të paraqitjes së nevojës apo të domosdoshmërisë, nëse kjo përmban kuptim të përzgjedhjes (mes të vepruarit apo mos vepruarit me të) dhe nëse është i sigurt se nuk është i abroguar apo që nuk është i mbështetur në argument të saktë, apo që ka mundësi që argumenti mos të jetë i mirëfilltë në argumentim, apo të ngjashme me këto”.**

Ndërsa, nëse vazhdimisht veprohet sipas pakicës, do të jenë të pashmangshme disa çështje:

E para: Praktika e tillë është kundërshtim i rrugës së të parëve në atë që ata vazhdimisht e kanë anashkaluar, si dhe është kundërshtim i asaj që ata vazhdimisht e kanë praktikuar.

E dyta: Praktika e tillë nënkupton lënien e asaj që ata ishin të rregullt ndaj saj, kështu që kushtimisht praktika e asaj që ata nuk kanë qenë të rregullt ndaj saj, nënkupton kundërshtimin e asaj që ata ishin të rregullt ndaj saj.

E treta: Praktika e tillë mund të jetë mjet për t'i fundosur elementet e asaj që ata **(selefi)** ishin të rregullt ndaj saj, si dhe do të konsiderohej afirmim i të kundërtës së saj, sepse pasimi me vepra nënkupton më shumë se pasimi me fjalë, e nëse kjo ndodhë nga ai që pasohet, atëherë është edhe më e rënd.

Prandaj, kujdes çdo kujdes nga kundërshtimi i të parëve **(selefit)**, sepse çdo njeri që ka ndonjë të mirë, më meritoret për të, janë ata. All-llahu na ndihmoftë!” Përfundoi fjala e Shatibiut, RahimehUllah!

Pjesa e tretë: Çështja të mos ketë qenë e praktikuar tek ta fare. S’do mend se ajo që del jashtë praktikës së gjithë tyre, konsiderohet bidat dhe sherr, kuptohet që nëse vepra është nga ato me të cilat vepruesi kërkon afrim me të tek Allahu. Kjo nuk vlen për ato të zakonshmet **(që nuk janë pjesë e ibadetit)**, sepse esenca e tyre është e lejuara.

Për këtë, çdo njeri që vepron vepër që nuk është në përputhshmëri me Rrugën e Selefrit dhe me kuptimin e tyre të Kur’anit dhe Sunnetit i thuhet: Ti je bosh e bidatçi, ndjekës i jo Rrugës së besimtarëve.

Njerëz që thirren në emër të diturisë, i konsiderojnë të mira disa risi, qofshin ato që kanë të bëjnë me vepra inkurajuese apo në çfarë do çështje tjetër, për të cilat sahabet e Pejgamberit, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, nuk e adhuronin Allahun me to, prandaj, e gjithë kjo është gabim në fe dhe pasim i rrugës së të pafeve, ngase këta të cilët i perceptuan këto perceptime në këtë formë dhe kaluan nëpër këto shtigje, ose kanë kuptuar nga feja më shumë se sa që kuptuan të parët, ose janë shmangur nga kuptimi i vërtetë i saj, e kjo e fundit është e sakta.

“Pra, të parët nga Selefus-Salih janë ata që kanë qenë në Rrugën e drejt. Ata nuk i kanë kuptuar argumentet e përmendura dhe të tjera të ngjashme me to përveç së sipas asaj që kanë vepruar me të, ndërsa këto gjëra të shpikura (bidatet) as nuk kanë ekzistuar të ta e as nuk kanë vepruar me to.” (“El-muvafakat” nga Shatibiu 3/73).

Gjërat e shpikura janë disa kategorish: ka prej tyre që janë me përmbajtje të shirkut, ka prej tyre që janë bidate që të tërheqin drejt shirkut, si dhe ka praj tyre që janë bidate të cilat i dominojnë sunetet.

Këto gjëra të shpikura me të gjitha llojet e tyre, absolutisht nuk kanë ekzistuar në mesin e sahabëve e as të pasuesve të tyre (**tabi'inëve**). Në kohën e tyre nuk kishte varreza tek të cilat janë izoluar, e as ndërtim të kupolave mbi to e as nuk kërkonin ndërmjetësim nga të varrosurit në to.

Tek ta, po ashtu, nuk ka pasur as të atillë që kërkonin ndërmjetësim nëpërmjet shenjtërisë së pejgamberëve apo njerëzve të mirë, e as me autoritetin apo edhe me vetë qeniet e tyre. Ata as nuk zgjedhnin që lutjet e tyre t'i bënin tek varret, e as nuk kishin festa të mevludit e as festa për qëllime të tjera.

Të gjitha këto, me pajtueshmëri të plotë të muslimanëve, asnjëherë nuk kanë ekzistuar në mesin e tyre (**gjeneratave të para**).

Pra, përderisa puna qëndron kështu, ato me të cilat të mëvonshmit kanë argumentuar me to për t'i justifikuar gjërat e shpikura të tyre ndahen në tri grupe:

E para: Citate të respektuara kuranore, të interpretuara sipas tekave të tyre e të ndryshuara kuptimet e tyre.

E dyta: Hadithe, të ndara në dy grupe:

I pari: Hadithe autentike por jo sipas asaj që ata e kuptuan nga to dhe në pa përputhshmëri me synimet e tyre, mirëpo të ndryshuara nga kuptimet dhe kontekstet e tyre.

I dyti: Hadithe të dobëta dhe të pavërteta, eh që sa të shumtë janë tek ta e sa të ngazëllyer janë me to, e sa fanatik janë ndaj tyre e sa e dashur për ta është përmendja dhe shpërndarja e tyre!

E treta: Tregime dhe ëndrra të cilat ia përcjellin njeri tjetrit sikur ato të ishin nga referencat e Legjislacionit (**Sheriatit**).

Zgjidhja e vetme për të argumentuar me citate nga Kur'ani dhe hadithet autentike bëhet në dy forma:

E para: Ajo me të cilën argumentojnë bidatçinjët nuk përmban kuptimin e synuar nga ta.

Ehlus-Suneti, janë pasues të kuptimit të parëve-Selefit, ata e kuptojnë (**argumentin**) ashtu si nuk e kanë kuptuar bidatçinjët, kështu që, fillimisht,

kuptimi i të mëvonshmëve (**bitaçinjëve**) refuzohet me kuptimin e të parëve-Selfit.

E dyta: - Kjo është degë e të parës- Të thuhet: A kanë vepruar të parët (**Selefus-Salih**) me kuptim të mëvonshmëve në atë me të cilën argumentojnë këta apo nuk kanë vepruar me të? Njëzëri është se të parët nuk kanë vepruar me këto gjëra të shpikura.

Assesi nuk ka mundësi që një bidatçi të sjellë një vepër të të parëve që është në kundërshtim me praktikën e sahabëve.

Kështu pra, Ehlus-Suneti janë pasues të veprave të të parëve nga sahabët dhe përcjellësit e tyre (**tabi'inët**), ndërsa e kundërta është me të mëvonshmit, të cilët e veprojnë atë që nuk janë të urdhëruar.

Po në këtë kuptim është edhe ajo çfarë është transmetuar nga Omeri – radijAllahu anhu!- që ka thënë: **“Do të ketë njerëz që kanë për t’iu polemizuar me kuptime të përgjithshme të Kur’anit, prandaj ju kthejuani atyre me sunete, sepse bartësit e suneteve janë më të diturit për Librin e Allahut”**

Për këtë arsye, është e pamundur të gjesh ndonjë grup prej grupeve të devijuara e as nga kundërshtarët tjerë që të ketë mundësi të argumentojë për orientimin e tij me anën e qartë të argumenteve.

Prandaj, realiteti është në vërtetësinë e të argumentuarit e jo thjeshtë vetëm në të **“argumentuar.”**

Shatibiu, pas përmendjes së përgjithshme të këtyre kuptimeve, ka thënë: **“Bazuar në të gjitha këto, është obligim për çdo analist që shqyrton ndonjë prej argumenteve të fesë, ta ketë në konsideratë atë se si e kanë kuptuar të parët atë, se si kanë vepruar me të, sepse kështu është më afër të vërtetës dhe më e drejtë në dituri dhe vepër.”**

Atëherë, kur kjo të jetë qartësuar dhe të dal në shesh, është shfaqur e vërteta (**hakku**) dhe është lartësuar, kështu që atyre që më meritë u takon privilegji i të atribuuari drejt Selefus-Salih, mbështeten në këto çështje të cilat i përmendem.

1 - Ashtu si ka qenë praktika e sahabëve e njohur, ata (**pasuesit**) veprojnë me të.

2 - Nëse ndonjë prej tyre (**sahabëve**) është veçuar me ndonjë mendim përderisa pjesa tjetër e tyre e kanë kundërshtuar, atë e kthejnë te Allahu dhe i Dërguari, sal-Iallahu 'alejhi ue sel-lem, po ashtu siç i ka urdhëruar ata Zoti i tyre kur ka thënë: **“Nëse keni mosmarrëveshje ndaj ndonjë çështjeje, atëherë atë kthejeni te Allahu dhe te i Dërguari, nëse vërtetë besoni në Allahun dhe**

Ditën e Fundit, kjo është më e mirë për ju së mosmarrëveshja dhe sjellë përfundim më të mirë” (Nisa: 59).

Pra, ka urdhëruar për tu kthyer te Allahu që nënkupton te Fjala e Tij e zbritur, te Kur’ani i madhërishëm, gjithashtu urdhëroi për tu kthyer te i Dërguari i Tij, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, që nënkupton të kthyerit tek ai gjatë jetës së tij, e te suneti i tij autentik pas vdekjes së tij, si dhe për pasim të shikohet praktika e shumicës.

Në këtë rregull të tyre nuk është shfaq ndonjë mangësi –elhamdulillah-, e as që e ka zëvendësuar atë ndonjë çrregullimi, sepse kjo është rregull e qartë, rruga e pasuar dhe e çiltër, drejtimi i drejt, sipas së cilës kanë vepruar të katër imamët në shumicën e çështjeve të tyre në fikh –Allahu i mëshiroftë e ua shtoftë shpërblimin!-

3 - Atë që nuk e kanë praktikuar këta të ndershëm, kam për qëllim sahabët e të Dërguarit, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, nga çështjet e adhurimeve, konsiderohet e shpikur që është shpikur nga të mëvonshmit.

Sahabët dhe pasuesit e tyre, nuk e kanë lenë ndonjë vepër pa vepruar, përveç, nga perceptimi i drejt i tyre, si dhe për kuptimin e drejt të argumenteve të Kur’anit dhe Sunetit.

Ata nuk kanë lenë çfarë kanë lenë nga ajo që e shpikën të tjerët pas tyre, meqenëse ekzistonin të njëjtat arsye me të cilat shpikësit i justifikonin shpikjet e tyre, përveç se për shkak të kuptimit të tyre të drejt ndaj çështjeve të Fesë.

E as nuk u shmangen nga ajo që janë shmangur, nga e cila të mëvonshmit kërkuar shpërblim dhe sevap në to, veçse që ajo punë e shmangur prej saj, të mos ketë qenë nga Feja, ngase ata ishin më të kujdesshmit nga të gjithë njerëzit ndaj asaj që konsiderohet të ketë qenë e mirë, më së shumti që bënin përpjekje për t’u futur në **“dyert”** e adhurimeve legjitime **(të shpallura)**, kështu që ata nuk lenin punë legjitime veçse e kryenin duke kërkuar sevap për të dhe duke kërkuar afrim tek Allahu me atë vepër.

Prandaj, s’ka më të zgjuar se sa ai që i pason ata në pranimin apo refuzimin e tyre, në perceptimin dhe diturinë e tyre, në kuptimin dhe veprën e tyre, e s’ka me më gjasë për të arritur çdo të mirë dhe afërsi! E sa me shpresë është që i tilli të arrin sukses në çdo aspekt të tij!

Dëgjimi i pushtetarit sipas bindjes së sunetit.

(Sherh Akide tahavije f. 77/79)

Burimi: [http://www.sahab.net/forums/index.php?s ... pic=139350](http://www.sahab.net/forums/index.php?s...pic=139350)

Ibën Ebil-Izz elHanefij, RahimehUllah thotë: **“Është obligim dëgjimi i tyre edhe në qoftë së bëjnë padrejtësi, ngase, si rrjedhojë e kryengritjes kundër tyre ndodhin shumë dëme në krahasim me padrejtësinë e tyre.”**

Përkundrazi në durimin ndaj padrejtësive të tyre falën mëkatet dhe shtohen shpërblimet.

Sepse Allahu i lartësuar nuk i ka lëshuar mbi ne, përveç së për shkak të veprave tona të këqija, ashtu siç janë veprat janë edhe shpërblimet.

Pra, është obligim që të bëjmë përpjekje në kërkim falje, pendim dhe përmirësim të veprave, Allahu i lartësuar thotë:

“Çfarë fatkeqësie që ju godet, është si pasojë e asaj që keni bërë vetë, por Ai fal shumë” (Shura: 30).

Po ashtu i Lartësuari thotë:

“Kur ju goditi fatkeqësia, ndërkohë ju i kishit goditur më parë armiqët tuaj dyfish, ju thatë: “Prej nga na erdhi neve kjo?!” Thuaj (o Muhamed): “Kjo ndodhi prej jush” (Ali Imran: 165).

Po ashtu i Lartësuari thotë:

“Çdo e mirë që të gjen ty o njeri, prej Allahut është, kurse e keqja që të godet, është prej vetes sate” (Nisa: 79).

Po ashtu i Lartësuari thotë:

“E kështu, Ne u japim pushtet disa keqbërësve mbi të tjerët, si dënim për veprat e tyre të këqija” (En’am: 129).

“E nëse masa e popullit dëshirojnë të çlirohen nga padrejtësia e prijësit atëherë edhe ata vet lë të largohen nga padrejtësia”

Shejh Albani, Allahu e mëshiroftë duke e komentuar këtë thotë:

“Në këtë sqarohet rruga e çlirimit nga padrejtësia e pushtetarëve, të cilët janë: “Nga mesi ynë dhe flasin sikur ne”, e çlirimi prej tyre është:

muslimanët duhet të pendohen tek Zoti i tyre, ta pastrojnë besimin e tyre, ta edukojnë vetveten dhe familjet e tyre në Islam të mirëfilltë, bazuar në fjalën e Allahut të lartësuar:

“...Me të vërtetë, Allahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli, derisa ata të ndryshojnë ç’kanë në vetvete...” (Rad: 11)

Po në këtë kuptim ka aluduar njëri nga thirrësit në fjalën e tij: **“Forcojeni Islamin në zemrat tuaja, atëherë forcohet në tokën tuaj”.**

Nuk është mënyra e çlirimit nga padrejtësitë, siç mendojnë disa njerëz nuk është përmes kryengritjeve me armë kundër pushtetarëve, apo përmes grusht shteteve ushtarake, kjo është nga bidatet bashkëkohorë dhe në kundërshtim me citatet sheriatike pjesë e të cilave është urdhri për ndryshimin e vetvetes, si dhe patjetër duhet ta kemi parasysh parimin:

Përmirësimin e bazës me qëllim të ngritjes së ndërtesës mbi të, Allahu i lartësuar thotë:

“...Vërtetë, Allahu e ndihmon këdo që e ndihmon Atë. Allahu është vërtet i Fortë dhe i Plotfuqishëm” (Haxh: 40)

Shkurtimisht rreth Ali Hasenit!

Përgatiti: Hoxhë Besim Gjellaj

Falënderimet i takojnë All-llahut Fuqiplotë, ndërsa salavatet qofshin mbi të Dërguarin tonë, Muhammedin sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem, familjen e tij, shokët e tij dhe gjithë ata që e pasojnë rrugën e tij.

Imam Ahmed ibën Hanbeli, Ibën Tejmije, Muhamed ibën Abdul-Vehabi, Ibën Bazi, Albani, Uthejmini e shumë të tjerë, All-llahu i mëshiroftë të gjithë, që të gjithë thirren në këtë rrugë sipas rrugës së selefët, ndjekën rrugën e atyre që moren mësim nga i Dërguari ynë, Muhammedi sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem, rrugën e sahabëve, All-llahu qoftë i kënaqur me ta!

Ringjalljen e umetit nuk e bënë duke i thyer dispozitat e All-llahut të Plotëfuqishëm, as duke folur kundër pushtetarëve, as duke bashkëpunuar me bidatxhinjë, kurse Jusuf Kardavi, Muhamed Hasani, Ebu Is’hak el-Huvejni, Magravi, Adnan Aruri, Ebul-Hasen el-Me’rebij etj nuk u mjaftuan më kaç por

me protesta, kryengritje, përmes partive politike duke bashkëpunuar me të gjitha grupacionet e devijuara!

Kinse me qëllim për t'ja kthyer krenarinë umetit, po si i kthehet krenaria umetit kur njeriu pason atë që është në kundërshtim me Kur'an dhe Sunet!

Mos harroni se këta që i përmenda, kam për qëllim këta pesë të fundit, ngase sipas Ali Hasenit janë selefij, shokë dhe dashamirë të tij, njerëz që e pasojnë hakun!

Kurse shejh Rebija, shejh Ubejdi, shejh Muhamedi, shejh Bazimuli etj etj, All-llahu i ruajttë, që llogariten nga dijetarët selefij, e disa prej tyre prej dijetarëve të mëdhej, nuk shpetuan nga gjuha e Ali Hasenit e as nga gjuha e pasuesve të tij, posaqerisht nga forumi i tij **“Kul-lu selefij-jin”**, forum i cili hedh vlerë ndaj dijetarëve selefij, vetëm e vetëm pse e mbrojnë menhexhin selefij dhe e luftojnë bidatin dhe pasuesit e tij.

Deshti All-llahu i madhërishëm, pastaj u bë shkaktarë shejh Suhejmi, All-llahu e ruajttë dhe na e bëri të qartë gjendjen e këtij forumi, ia dha hakun kur e quajti 'Forumi i dyshimeve'!

Vëllezër të ndëruar njeriu është me ata që i do, këtë na e vërteton thënja e Ibën Mes'udit: **“Llogaritni njerëzit në bazë të shokëve të tyre, ngase njeriu nuk shoqëron askënd përveç se atë që mahnitet me të”**.

Andaj mos pretendoni që dielli nuk ka lindë, dielli ka lindë mirëpo ata që nuk kan sy nuk e shohin, e vërteta është e dukshme ashtu sikur dielli në zenit, rrezet e tij ndonjëherë mbulohen nga retë mirëpo prap shfaqen, frikësojuni All-llahut të plotëfuqishëm, ngase një ditë do të jepni llogari para Mbretit të mbretërve, para Krijuesit Fuqiplotë, çfarë do t'i thoni All-llahut për mos sqarimin e së vërtetës, fshehjen, dredhimin dhe mos interpretimin e saj si duhet?!

Pshtjellim është të thuhet mospajtimi mes shejh Rebis dhe Ali Hasenit është mospajtimit i mocanikëve!. As nuk janë mocanikë në moshë!

E as në dije!

E as në xhuhd (kontribut)!

Nuk krahasohen në asnjë gjë, dallimi mes tyre është sikur dallimi mes lindjes dhe perendimit, i pari prijes në sunet, i dyti prijes në dalalet, më çfarë logjike krahasohet ndriçimi i hënës me ndriçimin e një ylli të vogël, që më shumë veshtërsi verehet ndriçimi i tij?!

Çështja e Ali Hasenit nuk është çështje mes shejh Rebis dhe Ali Hasenit, por çështje mes një njeriu të devijuar dhe selefive në anën tjetër, kjo na është bërë e qartë nga kritikantët e shejh Ahmed ibën Jahja en-Nexhmit, shejh Fewzanit, shejh Ubejdit, shejh Suhejmit, shejh Muhamedit, shejh Bazimulit e shumë dijetarëve të tjerë që e kanë kritikuar me fakte bindëse Ali Hasenin dhe pasuesit e tij.

Kritika ndaj tij është bërë me fakte bindëse, me xherh të hollsishtëm, nga shumë dijetarë selefij që të gjithë të njohur për mundin e tyre në mbrojtje të menhexhit selefij dhe në luftë kundër hizbijëve!

Pas kësaj të anashaklohen gjithë këta dhe të pasohet një person i devijuar verbërisht, me arsyetime të pa baza dhe të pa vlera, me të vërtetë është për të ardhur keq!

Përveç që mbrohet ky njeri me gjithë gabimet që i ka, me e quditshmë është kur ofendohen dijetarët selefij dhe disa heshtin, ku është xhelozia për këtë rrugë, për këtë menhexh, ku është dashuria për dijetarët selefij?!

Të thuhet për bidatxhi, kanë dituri, të lavderohen hizbit, kurse për dijetarë selefij të thuhet flasin shumë, ose të thuhet për filan dijetarin ai flet për çdo kënd?! Kjo na qenka e lejuar?! Çfarë drejtësie është kjo?

Thotë All-llahu i lartësuar:

“A do t’i bëjmë kriminelët të barabartë me muslimanët? Ç’është me ju, si gjykoni ashtu? A mos keni ndonjë libër, e prej tij mësoni?” (Kalem: 35-37).

Mashttrim është të thuhet Ali Haseni është nxënës i shejh Albanit, RahimehUllah, dhe përmes kësaj të manipulohet me xhemat!

Edhe Vasil ibën Ata’ ishte nga nxënësat e dijetarit të madhë, Hasan el-Basriut, RahimehUllah, kur Vasili lajthiti dhe u bë prijës në dalalet, themelues i sekti mu’tezilij, Hasan el-Basriu u denoncua prej tij, kështu që kur njeriu lajthiti çfarë dobie i bënë shejhu i tij ose çfarë e arsyeton lajthitjen e tij?!

Lavderimin e mesazhit të Ammanit, pohimin e asaj që e përmban ai mesazh, siç është:

01 - Thirrje për bashkimin e feve,

02 - Thirrje për lirinë e feve,

03 - Thirrje për vëllazëri midis feve,

04 - Thirrje për barazi midis feve,

05 - Thirrje për vënien në zbatim të ligjeve të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, etj.

06 - Lavderimin e bidatxhive, siç janë: Muhamed Hassani, Ebu Is'hak el-Huvejni, Adnan Aruri, Magravi, Ebul-Haseni e shumë të tjerë,

07 - Ofendimi i tij ndaj dijetarëve selefij,

08 - Sjellja e rregullave të reja në menhexhin selefij, prej tyre: pohimi se duhet të ketë konsensus kur dikujt i thuhet bidatxhi apo kur bëhet dikush xherh, etj.

A ndaj gjitha këtyre të heshtim?

All-llahut të lartësuar i takonë suksesi!.

Halebiu i përkrah dhe i përhap bazat më të rrezikshme të xhehmijve.

Shkroi: Rabi' ibën Hadi Umejri elMedkhali 13 Dhul Ki'de 1434h

Marrë nga: <http://www.sahab.net/forums/index.php?showtopic=139956>

Bismil-lahir Rahmanir Rahim

E gjithë lavdia i qoftë Vetëm All-llahut! Salavatet dhe selamet qofshin për të Dërguarin e All-llahut, për familjen dhe shokët e tij, si dhe për ata që e ndjekin udhëzimin e tij!

Më tej:

Sqarimi i të vërtetës dhe shkatërrimi i të kotës është ndër obligimet më të mëdha.

Kjo është metodologjia **(menhexhi)** e Kur'anit dhe Sunnetit dhe metodologjia **(menhexhi)** e selefëve të devotshëm.

Në kundërshtim me këtë është menhexhi i ithtarëve të devijimit dhe të kotës, për të cilët i Dërguari i All-llahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ka thënë:

أخوفني عليكم إن يخرج وأنا فيكم فأنا حديد وجه دونكم، وإن يخرج ولا ست فيكم فأمرؤ غير الدجال
”حديج ذ فسه والله خذ في فتى على كل مسلم“

“Tjetërkush pos Dexhxhalit më frikon më shumë për ju. Nëse ai del duke qenë unë mes jush, atëherë unë do të flas për ju. Por, nëse del kur unë të mos jem më mes jush, atëherë secili le të flasë për vete, kurse All-llahu është Mbrojtësi i secilit musliman.”

Ai, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, gjithashtu, ka thënë:

”إِنَّمَا أَخَافُ عَلَى أُمَّتِي الْأَيِّمَةَ الْمُضِلِّينَ“

“Unë frikohem për Ummetin tim nga prijësit devijues.”

Transmetojnë Ahmedi në Musned (5\278), Ebu Davudi në Sunen (4252), Tirmidhiu në Sunen (2229) dhe Ibën Maxhe në Sunen (3952).

Një prej atyre prijësve devijues është edhe Halebiu dhe ata të cilët i ndihmon ai në devijimet dhe bazat e tyre të prishura, siç janë Adnan Ar'uri dhe Ebul Hasen elMe'ribi.

Ky Halebiu ka marrë avaz ta ndihmojë të kotën dhe fitnet ka një kohë të gjatë. Gjithnjë kur një fitne e nxjerr kokën kundër të vërtetës dhe pasuesve të saj, ai vrapon për ta ndihmuar atë dhe për t'i mbrojtur ithtarët e saj.

Ky i mjerë e ndihmon të kotën ose me qëllim, megjithëse e di se ajo është e kotë, ose për shkak të injorancës rreth saj. Shkak i kësaj është injoranca e tij, mosnjohja e bazave dhe menhexhit të selefëve dhe largësia e tij nga morali dhe etika e tyre. Kush nuk e njeh të vërtetën, e armiqëson atë.

Shumë prej injorancave dhe devijimeve të tij ia kam refuzuar unë, por edhe të tjerët, mirëpo refuzimet ilmije selefije atij ia shtojnë edhe më tepër humbjen dhe kokëfortësinë në përkrahjen e së kotës. Kjo ngase natyra dhe menhexhi i prishur i tij janë që s'ka kthim në të vërtetën, pa marrë parasysh sa e qartë është e vërteta, dhe s'ka largim nga e pavërteta, pa marrë parasysh se sa e qartë është ajo dhe sa i madh është dëmi i saj.

Rrjedhojë e injorancës dhe devijimit të tij janë edhe përkrahja dhe përhapja që ua ka bërë bazave më të rrezikshme të xhehmijve, gjatë komentimeve të tij në librin **“elHauadith uel bida”**, të autorit etTartushi.

Le ta dijë lexuesi se libri i etTartushit me verifikim dhe komentim të Ali elHalebiut po përhapet ka njëzet e tri vjet, gjatë të cilave është botuar tri herë,

me aq sa di unë. Prandaj, shumë lexues janë mashtruar me këto baza xhehmije, të cilat i ka përkrahur dhe përhapur Halebiu.

E para – prej këtyre bazave të rrezikshme është mohimi i justifikimit të veprave dhe ligjeve të All-llahut, justifikim ky që bazohet në urtësinë e përkryer të All-llahut.

Ai, në faqen 10, duke e kritikuar etTartushin, thotë:

“Për dy gjëra autori, RahimehUllah, është i kundërshtuar:

E para: Mënyra e tij në diskutim është e ndikuar nga metodologjia e mu’tezilijve, dhe kjo vërehet në sqarimin e urtësive të ligjeve dhe në analogjitë fikhere, gjë në të cilën nuk mund të sigurohet nga rrëshqitja.

E dyta: Dobësia e tij në shkencat e hadithit, për shkak të së cilës e vëren se argumentohet me transmetime të dobëta dhe shpesh i transmeton hadithet sipas kuptimit, ku i ndodhin mangësi të qarta, ose gabohet gjatë referencave.

As e para e as e dyta nuk ia pakësojnë vlerën librit dhe nuk ia ulin pozitën. **“Ai është libër me një lëndë të mirë dhe të dalluar shkencore.”**

Këtu Halebiu e kritikon etTartushin për sqarimin e urtësive të ligjeve të Sheriatit. Ligjet e All-llahut, sipas Halebiut, nuk paskan urtësi. Kurse, kjo është në kundërshtim me dhjetëra tekste kur’anore, të cilat vërtetojnë se në ligjet e All-llahut ka urtësi, si dhe në krijimin e krijesave të Tij.

Ky mohim i dalë prej tij, e ka origjinën në injorancën e tij rreth menhexhit të selefëve, ose në besimin e tij të kotë, të cilin e ka përqafuar ky njeri.

Ai thotë: **“As e para e as e dyta nuk ia pakësojnë vlerën librit dhe nuk ia ulin pozitën.”**

Themi: Kjo përsosmëri është sipas kuptimit tënd, kurse sipas Ehlus Sunnetit bazat e kota që i përmban ky libër ia ulin vlerën atij në masë shumë të madhe.

E dyta – neglizhenca e Halebiut ndaj fjalëve që kanë lidhje me kaderin.

etTartushi, RahimehUllah, duke folur për bidatet e katër grupeve: havarixhëve, rafidijve, kaderijve, murxhieve dhe grupeve të tjera që degëzohen prej tyre dhe duke supozuar se të gjitha bidatet rrjedhin nga këto katër grupe, në faqen 34, thotë:

“Kjo sqarohet me shmebull: kaderi është një nga bazat e bidateve. Pastaj ithtarët e saj janë kundërshtuar në çështje që degëzohen prej kaderit dhe në çështje të tjera që nuk kanë lidhje me kaderin. Kështu të gjithë ata

pajtohen se veprat e robërve janë të krijuara prej tyre, e jo prej All-llahut, por kundërshtohen në degët e kaderit.”

Unë them: Besimi në kader është një prej bazave të imanit te Ehlus Sunneh.

Kur ai thotë: **“Kaderi është një nga bazat e bidateve”**, disa injorantë, madje edhe disa nxënës dije, mund të kuptojnë se besimi në kader është një prej bazave të bidateve. Këtë fjalë mund ta marrin për bazë ata që nuk i besojnë kaderit, ngase kjo fjalë del nga një njeri që ata e quajnë dijetar.

A nuk e kupton Halebiu se kjo është fjalë e kotë, dhe nëse gjendet në tekstin e librit duhet të korrigjohet duke sqaruar se shprehja e drejtë në këtë kontekst do të ishte: **“Mohimi i kaderit është një nga bazat e bidateve.”** Përndryshe, ajo fjalë është në kundërshtim me ajetet kur'anore dhe fjalët e të Dërguarit të All-llahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, që sqarojnë se kaderi është një prej bazave të imanit. Këtë bazë e kanë Ehlus Sunneh dhe grupet e tjera me përjashtim të kaderijve.

E treta – Halebiu e përkrah bazën më të rrezikshme të xhehmijve, atë bazë e cila çon deri te mohimi i Emrave të bukur dhe Cilësive të larta të All-llahut.

etTartushi në faqen 36, duke folur për grupet e devijuara për të cilat ka paralajmëruar i Dërguari i All-llahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, në hadithin e njohur, thotë:

“Nëse i Dërguari i All-llahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, me ndarjen e Ummetit të tij ka aluduar në bazat e këtyre bidateve, të cilat janë sikur trangu për degët, atëherë ato nuk e kanë arritur këtë numër deri më tani – kurse dituria i takon All-llahut. Mirëpo, koha vazhdon, Islami është prezent dhe pritet çdo hap. Asnjë gjeneratë dhe asnjë shekull nuk mbetet pa shpikje të reja të bidateve.

Por, nëse Profeti, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, me **“grupe”** e ka pasur për qëllim secilin bidat që është shpikur dhe është futur në Fenë Islame, i cili nuk përshtatet me bazat e Islamit dhe nuk pranohet nga rregullat e tij, duke mos e marrë në konsideratë ndarjen që e përmendëm dhe pa marrë parasysh nëse ato janë lloje të një grupi ose lloje me baza të ndryshme – dhe si duket këtë e ka pasur për qëllim, kurse dituria i takon All-llahut – atëherë numri i tyre është shumë i madh se shtatëdhjetë e dy.

Në këtë rast, hadithi vërtetohet duke i nxjerrë ithtarët e bidateve ekstreme jashtë numërimit dhe duke mos i llogaritur pjesë të Ummetit ose anëtarë të kibles së njëjtë, siç janë mohuesit e shenjave nga mesi i kaderijve, ngase nuk ka mundësi të ndodhin krijesat ose të vërtetohet Krijuesi pa u vërtetuar shenjat; ose siç janë mensurijtë e ekstremistët e tjerë të ngjashëm.

Çfarë bëri Halebiu në lidhje me këtë fjalë?

Halebiu e komentoi fjalën e etTartushit: **“Në këtë rast, hadithi vërtetohet duke i nxjerrë ithtarët e bidateve ekstreme jashtë numërimit dhe duke mos i llogaritur pjesë të Ummetit ose anëtarë të kibles së njëjtë.”**

E komentoi këtë fjalë në fusnotë duke thënë:

“Ky është dallim preciz të cilin e bën autori, RahimehUllah, mes “Ehlus Sunneh” dhe “Ehlul Kible”. Shpesh këto dy kuptime përzihen në mendjet e shumë njerëzve, prandaj mendo!”

Unë them:

01 – Fjala e autorit nuk e ka kuptimin që e nxjerr dhe që e thotë Halebiu. Fjala e autorit është e qartë në bërjen e dallimit të muslimanëve, sunnij dhe bidatçinj, me ekstremistët që janë jashtë Islamit. **“...dhe duke mos i llogaritur pjesë të Ummetit ose anëtarë të kibles së njëjtë.”** Kjo është fjalë e qartë e etTartushit se ai ekstremistët e bidatçinjve nuk i llogarit pjesë të këtij Ummeti dhe nuk i llogarit ndër **“Ehlul Kible” (muslimanë që kanë një kible të përbashkët)**, dhe jo siç thotë Halebiu.

02 – Halebiu e përkrah në mënyrë të tërësishme dhe pa kufizime refuzimin e etTartushit ndaj atyre që i mohojnë shenjat. Ai këtë fjalë e komenton në fusnotë duke thënë: **“Ata janë ithtarët e Ma’merit nga mu’tezilijtë, të cilët thonë se nuk lejohet që All-llahu të krijojë shenja dhe Ai nuk cilësohet me fuqi për të krijuar shenja.”**

Kjo është nga injoranca e Halebiut për menhexhin e selefëve dhe për atë që është në kundërshtim me të, e që është menhexhi i xhehmijve dhe pasuesve të tyre si esh’arijtë dhe kul-labijtë. Unë tem:

Me këtë injorancë të errët ai pajtohet me fjalën e etTartushit: **“...ngase nuk ka mundësi të ndodhin krijesat ose të vërtetohet Krijuesi pa u vërtetuar shenjat.”** Kurse, kjo është fjalë e kotë deri në fund të kotësisë, ngase ajo rrjedh nga pasimi i xhehmijve – grupit më të devijuar dhe më të largët nga Libri i All-llahut, Sunneti i të Dërguarit të Tij dhe metodologjisë së sahabeve të nderuar dhe atyre që kanë ecur rrugës së tyre në mënyrën më të mirë. Të gjithë këta u besojnë argumenteve të shumta nga Sheriati dhe nga natyra, si dhe nga natyrshmëria e pastër e krijesave të All-llahut, të cilat i ka krijuar që të besojnë në All-llahun, në Emrat dhe në Cilësitë e Tij. Këto argumente vërtetojnë se All-llahu është Veprues i asaj që Ai Vetë dëshiron.

Kjo bazë e kotë i ka çuar xhehmijtë që t’i mohojnë Emrat e bukur dhe Cilësitë e larta të All-llahut, si dhe veprat e Tij që janë argument për Urtësinë,

Madhërinë, Madhështinë dhe Përsosmërinë e Tij. Ata, duke i mohuar këto, e barazuan All-llahun me mosekzistencën.

Esh'arijtë dhe kul-labijtë i ndoqën xhehmijtë në këtë bazë dhe kjo bazë e kotë i çoi ata deri te mohimi i shumë Cilësive të All-llahut dhe deri te mohimi i veprave të Tij të ndërtuara mbi Dije dhe Urtësi të përsosur.

Po ia lë hapësirën fjalës së Shejhul Islam Ibën Tejmijes, RahimehUllah, për asgjësimin e kësaj baze të rrezikshme.

Ai, RahimehUllah, në **“Minhaxh Ehli Sunneh”**, 1\112, ka thënë:

“Këta (1) janë të parët që e kanë shpikur në Islam mendimin se paraqitja e krijesave (e botës) vërtetohet me paraqitjen e trupave, kurse paraqitjen e trupave e vërtetojnë me paraqitjen e asaj që është e lidhur me to, e që janë shenjat. Ata thonë se trupat nuk ndahen nga shenjat e paraqitura. Ajo që nuk ndahet nga paraqitjet (dukuritë), ose ajo që nuk paraqitet para dukurive është dukuri, ngase nuk mund të ketë dukuri që nuk kanë fillim.”

Ai, RahimehUllah, më tej në faqet 112–113 thotë:

“Pastaj, këta xhehmijtë, përkrahësit e kësaj baze të shpikur (bidat) duhej t'i përmbahen kësaj baze në çdo rast, prandaj kanë thënë se Zoti nuk mund të ketë cilësi e as vepra, ngase ato janë shenja dhe dukuri. Shenjat dhe dukuritë paraqiten vetëm te trupat, kurse trupat janë paraqitje (dukuri). Kështu, domosdo duhet të mos ketë te Zoti dituri, fuqi, të folur, dëshirë, mëshirë, kënaqje, hidhërim, e as ndonjë cilësi tjetër, por të gjitha këto me të cilat cilësohet Zoti janë krijesa të ndara prej Tij.

Xhehmijtë thonë se kur ne themi që Zoti flet, kjo është alegori. Kurse, mu'tezilijtë thonë se ai flet me të vërtetë, por domethënia e fjalëve të tyre është e njëjtë. Baza e tyre ishte te çështja e materies, nga e cila janë degëzuar këto bidate.

Pas këtyre erdhi Ibën Kul-labi, kur u shfaq sprova e njohur me të cilën u sprovua Imam Ahmed ibën Hanbeli dhe imamët e tjerë të Sunnetit, por All-llahu e përforcoi Imam Ahmed ibën Hanbelin, kur në atë kohë mes Ummetit ndodhën shumë gjëra që janë të njohura dhe u ngritën shumë kundërthënie dhe grindje në lidhje me këto çështje.

Atëherë, Ebu Muhammed Abdull-llah ibën Se'id ibën Kul-lab elBasri shkroi disa libra në refuzim kundër xhehmijve dhe mu'tezilijve, ku i sqaroi kontradiktat e tyre me veten në lidhje me këtë temë dhe demaskoi shumë prej devijimeve të tyre, por ua pranoi atë bazë, e cila është burimi i bidateve.

Për ta përkrahur këtë bazë ai tha se Zotit nuk i ndodhin gjëra me zgjedhje, nuk flet sipas dëshirës dhe fuqisë dhe nuk e ka thirrur Musain në Tur, madje as që ndodh prej Tij thirrje reale, besimi i robërve dhe veprat e tyre të mira nuk janë shkak për kënaqjen e All-llahut dhe për dashurinë e Tij, e as kufri nuk është shkak për hidhërimin e Tij.

Sipas tij, pas veprave të robërve nuk ka te Zoti dashuri ose kënaqësi, e as hidhërim ose urrejtje, por as ndonjë tjetër cilësi për të cilën kanë treguar tekstet e Kur'anit dhe Sunnetit. All-llahu i Lartësuar ka thënë:

“قُلْ إِنْ كُنْتُمْ تُحِبُّونَ اللَّهَ فَاتَّبِعُونِي يُحْبِبْكُمُ اللَّهُ”

“Thuaju (o Muhamed): “Nëse ju e doni All-llahun, atëherë më ndiqni mua, që All-llahu t’ju dojë.” (Ali Imran: 31)

“ذَلِكَ بِأَنَّهُمْ اتَّبَعُوا مَا أَسْخَطَ اللَّهَ وَكَرِهُوا رِضْوَانَهُ فَأَحْبَطَ أَعْمَالَهُمْ”

“Kjo, sepse ata pasuan atë që shkakton zemërimin e All-llahut dhe urreyen pëlqimin e Tij e kështu, Ai ua zhvlerësoi atyre veprat.” (Muhammed: 28)

“فَلَمَّا آسَفُونَا انْتَقَمْنَا مِنْهُمْ”

“E, kur Na zemëruan, Ne u hakmorëm ndaj tyre.” (ezZuhruf: 55)

“إِنْ تَكْفُرُوا فَإِنَّ اللَّهَ غَنِيٌّ عَنْكُمْ وَلَا يَرْضَىٰ لِعِبَادِهِ الْكُفْرَ وَإِنْ تَشْكُرُوا يَرْضَهُ لَكُمْ”

“Nëse ju e mohoni Atë, dijeni se All-llahu është vërtet i Pavarur prej jush. Megjithatë, Ai nuk është i Kënaqur me mosmirënjohjen e robërve të Tij, por nëse e falënderoni, kënaqet me ju.” (ezZumer: 7)

“قَالَ لَهُ كُنْ فَيَكُونُ إِنَّ مَثَلَ عِيسَىٰ عِنْدَ اللَّهِ كَمَثَلِ آدَمَ خَلَقَهُ مِنْ تُرَابٍ ثُمَّ

“Rasti i Isait për All-llahun është si rasti i Ademit që e krijoi prej baltës e pastaj i tha: “Bëhu!” – dhe ai u bë.” (Ali Imran: 59)

“وَلَقَدْ خَلَقْنَاكُمْ ثُمَّ صَوَّرْنَاكُمْ ثُمَّ قُلْنَا لِلْمَلَائِكَةِ اسْجُدُوا لِآدَمَ”

“Ne ju krijuam e pastaj ju dhamë formën; e u thamë engjëjve: “Përuljuni në sexhde Ademit!” (el-A’raf: 11)

Si dhe tekste të tjera të ngjashme nga Kur’ani dhe Sunneti, të cilat nuk mund të përmbliidhen lehtë, e që arrijnë qindra tekste nga Kur’ani dhe hadithi. **“Disa prej tyre kemi përmendur edhe në vende të tjera, siç i kemi përmendur fjalët e selefëve dhe të mëvonshmëve rreth kësaj baze.”** – citat i mbaruar i Ibën Tejmijes

Unë them: Këto janë rezultatet dhe mynxyrat që i sjell kjo bazë e rrezikshme, e cila nuk i ka lëvizur asgjë në zemër Halebiut. Sikur ta kishte ditur kotësinë e kësaj baze, thellësinë e devijimit të ithtarëve të saj, luftën e selefëve kundër tyre dhe tekfirin kundër atyre që e kanë thënë këtë bazë, ai nuk do të kishte heshtur për të. Por, kur e kam mburra me mëkatën dhe pretendon se është dijetar dhe al-lame, ne i themi: **“Të poshtëroftë besimi në këtë bazë të shkatërruar!”**

Shejhul Islam në **“elMinhaxh”**, 1\110 thotë:

“Argumentimi me këtë metodë ka sjellë deri te mohimi i Cilësive të All-llahut dhe deri te mohimi i veprave të All-llahut që janë të Tijat. Kjo ka sjellë deri te bidatet e xhehmijve që janë të njohura te selefët e Ummetit. Përmes kësaj dehrijtë (ateistët, materialistët) kanë gjetur rrugë për ta akuzuar shpalljen që e kanë sjellë të dërguarit prej All-llahut. Ky argumentim nuk ka kontribuar në vërtetimin e Fesë, e as në shtypjen e armiqve të saj ateistë. Ai i ka çuar ithtarët e tij deri te fjala se All-llahu nuk flet, por fjalët e Tij janë të krijuara, ngase po të ishte kjo bazë e vërtetë, domosdoshëm duhet të thuheshin këto fjalë.”

Kurse, Ibën Kul-labi dhe pasuesit e tij kanë shpikur se diçka e caktuar prej Fjalëve të All-llahut është e përhershme **(e diçka e krijuar)**, e ajo është: ose kuptimi i fjalëve, ose shkronjat, ose shkronja dhe zëra të caktuar që bashkohen me njëri-tjetrin që në amshim. Të gjitha këto janë mendime të shpikura pasi është shpikur bidati i mendimit për krijimin e Kur'anit. **“Këto fjalë janë të prishura në bazë të Sheriatit dhe logjikës aq shumë, sa që përshekrimi i prishjes së tyre zgjatet shumë. Ata që i përkrahin këto mendime e kanë sqaruar prishjen e fjalës “Kur’ani është i krijuar” që e thonë xhehmijtë dhe mu’tezilijtë, kështu që fjala e secilit grup e sqaron prishjen e fjalës së grupit tjetër, e nuk e sqaron vërtetësinë e fjalës së vet, ngase të gjitha këto fjalë janë në kundërshtim me të vërtetën dhe janë të kota.”** – citat i mbaruar i Ibën Tejmijes

E katërta – Halebiu e përkrah bazën e rrezikshme të xhehmijve, të cilët pretendojnë se veprat e All-llahut nuk justifikohen **(nuk përmendet urtësia e tyre)** dhe se ligjet e Tij nuk përmbajnë urtësi e as dobi.

Në faqen 51 etTartushi, duke folur për shkakun për të cilin Profeti, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, nuk ka vazhduar në faljen e teravive në Ramazan me xhemat, ai e përmend shkakun dhe e përmend fjalën e Profetit, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, **“Nga frika se mos ju bëhet obligim.”**

Më mirë do të kishte qenë sikur të ishte mjaftuar me këtë sqarim! Mirëpo, ai vazhdon dhe thotë: **“Kadi Ebu Bekri ka thënë: Ka mundësi që All-llahu i ka shpallur atij se nëse vazhdon me këtë namaz me xhemat Ai do t’ua bëjë obligim: ose vetëm pse Ai ka dashur t’ua bëjë obligim – sipas mendimit**

tonë se Veprat e të Amshueshmit nuk justifikohen; ose për shkak se falja e vazhdueshme me ta do të shkaktonte besim dhe gjendje që do të ishte më mirë për ta që ta kenë obligim këtë namaz. Por, ka mundësi që ai ka dashur të thotë se ka pasur frikë se ndonjëri nga Ummeti i tij më vonë do të mendojë se ky namaz është obligim, nëse ai ishte falur gjithnjë. Të gjitha këto kuptime janë të siguruara që të mos ndodhin pas vdekjes së Profetit, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem.”

D.m.th: ky Kadi Ebu Bekr ibën el-Arabi shprehet qartë se e ka mendimin që veprat e të Amshueshmit të Lartësuar nuk justifikohen. Këtë e ka miratuar etTartushi dhe me të dy është pajtuar Halebiu rreth kësaj teme.

A nuk e di ai se kjo fjalë është e kotë dhe devijim, se kundërshtohet me dhjetëra tekste të Kur'anit dhe Sunnetit dhe se kundërshtohet me menhexhin e selefëve të devotshëm?! A e ka miratuar këtë mendim i kënaqur me të, apo është injorant në lidhje me menhexhin e selefëve dhe nuk e di se ky besim është një prej besimeve të xhehmijve të devijuar? Cilado nga këto dy mundësi është shumë e shëmtuar, dhe më e ëmbla prej tyre është shumë e hidhur.

E pesta – Në faqet 135–136 etTartushi e merr rrugën e xhehmijve dhe esh'arije në mohimin e justifikimit të veprave të All-llahut, që ndërtohen mbi urtësi. Pasi flet në lidhje me muajt e shenjtë thotë:

“Nëse thuhet: **“Pse disa muaj janë më të vlefshëm dhe më të mëdhenj se disa të tjerë?”** – ne përgjigjemi: Veprat e të Amshueshmit, sipas mendimit tonë, nuk justifikohen. Atij që nuk vepron për ndonjë qëllim ose arsye nuk lejohet t'i thuhet: **“Pse ka bërë kështu? Pse nuk ka bërë kështu?”** Mirëpo, njerëzit e imtësive japin përgjigje për këtë dhe thonë se ka dobi në ndalimin e pasrejtësisë në këto muaj, për shkak të pozitës së lartë që e kanë në gjykimin e Krijuesit të tyre. **“Ndoshta kjo çon deri te braktisja e plotë e padrejtësisë, për shkak të shuarjes së zjarrit të saj gjatë kësaj periudhe dhe uljes së fanatizmit dhe hovit. Gjëja, gjithashtu, e tërheq shoqen dhe të ngjashmen e saj dhe e largon të kundërtën dhe armiken.”**

Çfarë bëri Halebiu me këtë fjalë?!

01 – U pajtua me autorin etTartushi në këtë devijim xhehmij, i cili e përmban mohimin e justifikimit të Veprave të All-llahut, të cilat ndërtohen mbi dije të gjerë dhe urtësi të plotë, dhe të cilat përmbajnë mirësi madhështore dhe mënjanojnë dëmtime shkatërruese.

Kjo përkrahje e Halebiut buron nga ëndjet dhe injoranca e tij në lidhje me Librin e All-llahut, Sunnetin e të Dërguarit të Tij, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, dhe menhexhin e selefëve të devotshëm.

02 – E përkrahu autorin për refuzimin kundër njerëzve të imtësive, nga mesi i mu'tezilijve, me përkrahje të plotë. Në fusnotën e tij në faqe 136 thotë:

“E gjithë kjo është e refuzuar, ngase përndryshe do të ishte detyrim ndaj All-llahut, kurse All-llahu nuk detyrohet me asgjë. Shih “Minhaxh esSunneh enNebewijje”, 1\171. Në librin “elHikmetu uetta’lil fi ef'alil-lahi te'ala”, 108 – 119, të vëllait Shejh Muhammed ibën Rabi' elMedkhali, mund të gjeni shpjegim të detajuar të bukur rreth kësaj çështjeje.”

Kështu ka thënë, por nuk e ka refuzuar fjalën e etTartushit: **“Veprat e të Amshueshmit, sipas mendimit tonë, nuk justifikohen, ngase i Lartësuarit nuk vepron për ndonjë qëllim ose arsye...”**

etTartushi dhe paraardhësit e tij këtë e kanë marrë prej xhehmijve, të cilët e mohojnë urtësinë nga Veprat e All-llahut, nuk lejojnë që Veprat e Tij të justifikohen dhe mohojnë që Vepra e Tij të ketë qëllim të dashur dhe përfundim të lënduar. Këtë e mohojnë duke pretenduar se po e lartësojnë All-llahun nga të qenit të veprimit të Tij për ndonjë qëllim ose arsye. Kurse, ky është devijimi i vërtetë, ngase është mohim i Urtësisë së All-llahut në Veprat e Tij dhe mohim i asaj se Veprat e Tij përmbajnë dobi dhe e ndalojnë dëmtimin.

Këtë kotësi e miraton Halebiu.

Pastaj, analizoje fjalën e Halebiut: **“E gjithë kjo është e refuzuar!”** Kjo del prej injorancës së tij të thellë.

Fjala e këtij grupi të devijuar përmban edhe të vërtetë edhe të kotë. E vërteta qëndron te pohimi i dobisë në ligjet dhe krijimin e All-llahut. Kjo është një çështje që e miratojnë dhe e besojnë Ehlus Sunneh para të tjerëve. Kurse, e kota qëndron në atë që ky grup i devijuar thotë se All-llahut i obligohet të veprojë kështu, ose të mos bëjë kështu. Ky është devijim i rrezikshëm, të cilin e luftojnë Ehlus Sunneh, lavdi All-llahut! All-llahut nuk i bëhet obligim asgjë kundërt askujt prej krijesave të Tij. Ai bën ç'të dojë, por Veprat dhe Fjalët e Tij ndërtohen mbi dituri, urtësi dhe dobi. Ai është i Urti, i Gjithëdijshmi. Atij nuk i fshihet asgjë në Tokë e as në qiell. Ai nuk bën të padrejtë as sa një grimë. Nuk pyetet për atë që e bën, kurse ata **(krijesat)** pyeten.

03 – Për shkak të injorancës së vet Halebiu i referohet fjalës së Shejhul Islamit, duke menduar se ai e ka të njëjtin menhexh me të, por dallimi mes këtyre dy menhexheve është shumë i madh dhe ato janë kontradiktore si e vërteta me të kotën, si dija me injorancën dhe si errësira me dritën.

Shejhul Islami në referencën e përmendur e refuzon kotësinë e xhehmijve dhe esh'arijve, siç e refuzon edhe kotësinë e kaderijve dhe mu'tezilijve. Mirëpo, Halebiu nuk e kupton as këtë e as këtë.

Këtu po jua japim fjalën e Shejhul Islamit, të cilës i referohet Halebiu.

Ai, RahimehUllah, në **“elMinhaxh”**, 1\170–172, duke i përmendur fjalët e rafidiut Ibnul Mutahhar, thotë:

“E sa i përket thënies së tyre se All-llahu nuk e bën atë që është më e dobishme për robërit e Tij, por e bën atë që është e dëmshme, siç është bërja e mëkateve dhe llojeve të ndryshme të kufrit ose thënies së tyre se të gjitha llojet e shkatërrimit që ndodhin nëpër botë i përkasin Atij... ne E madhërojmë dhe E pastrojmë All-llahun nga kjo thënie.”

Më pas ai, RahimehUllah, duke e refuzuar këtë fjalë, thotë:

“Këtë fjalë e kanë thënë një grup i kelamistëve nga pohuesit e kaderit, mirëpo ajo, gjithashtu, është fjalë e kelamistëve të shiave. Imamët e Ehlius Sunneh dhe xhumhuri i tyre nuk e thonë këtë fjalë. Ajo që thonë ata është se All-llahu është Krijuesi i çdo gjëje, është Zoti dhe Mbreti i çdo krijese. Asnjë gjë nuk del dot jashtë pushtetit dhe fuqisë së Tij dhe asnjë gjë nuk është tjetër pos krijesë e Tij. Në këtë bëjnë pjesë të gjitha veprat e gjallesave. Ai është Krijuesi i adhurimeve të melaikëve dhe besimtarëve dhe i të gjitha lëvizjeve të robërve të Tij.”

Kaderijtë e mohojnë prej pushtetit të Tij më të mirën që ndodhet në të, e që është bindja e profetëve, melaikëve dhe besimtarëve. Ata thonë se All-llahu nuk e ka krijuar atë, nuk është i fuqishëm për ta futur robin e Vet në të dhe për ta frymëzuar me të, e as që mund ta bëjë veprues të saj atë që nuk është veprues i saj.

Kurse, miku i All-llahut Ibrahim, alejhis selam, ka thënë: **“O Zoti ynë! Na bëj të përulur ndaj Teje! Bëj që edhe prej pasardhësve tanë të ketë të përulur ndaj Teje!”** Ka kërkuar prej All-llahut që ta bëjë të përulur dhe të bëjë prej pasardhësve të tij popull të përulur. Ky është argument i drejtpërdrejtë se All-llahu e bën mosvepruesin veprues. Ibrahim, gjithashtu, ka thënë: **“O Zoti im, bëj që unë dhe pasardhësit e mi të kryejmë përherë namazin!”** Pra, ka kërkuar prej All-llahut të Lartësuar që ta bëjë kryerës të namazit, që do të thotë se ai e dinte që All-llahu e bën robin e Tij kryerës të namazit. All-llahu ka treguar për lëkurën dhe gjymtyrët, duke e miratuar fjalën e tyre, dhe ka thënë:

“أَنطَقَنَا اللَّهُ الَّذِي أَنطَقَ كُلَّ شَيْءٍ”

“All-llahu, i Cili ia jep aftësinë e të folurit çdo gjëje, na ka bërë që të flasim.” (Fussilet: 21)

Domethënë se All-llahu i bën të flasin të gjithë ata që flasin.

Sa i përket pohimit se Ai nuk e bën atë që është më e dobishme për robërit, ose se nuk kujdeset për mirëqenien e tyre, ky është një pohim rreth të cilit ka kundërthënie mes njerëzve.

Disa pohues të kaderit e kanë këtë mendim. Ata thonë se krijimi dhe urdhrat e All-llahut kanë të bëjnë kryekëput vetëm me dëshirën e Tij dhe nuk kanë lidhje me interesin ose dobinë e krijesave. Ky është mendimi i xhehmijve. Kurse, shumica e dijetarëve janë të mendimit se All-llahu i urdhëron robërit e Vet me urdhra që janë në dobi të tyre dhe i ndalon nga ato që janë në dëm të tyre, se zbatimi i urdhrit është në dobi të përgjithshme të atyre që e zbatojnë dhe se dërgimi i të dërguarve është në dobinë e përgjithshme, megjithëse për disa individë është e dëmshme për shkak të mëkateve të tyre. All-llahu ka shkruar në Librin që gjendet tek Ai mbi Arsh: **“Mëshira Ime ka ngadhënjyer mbi hidhërimin Tim.”** Sipas një transmetimi tjetër: **“Mëshira Ime e ka parakaluar hidhërimin Tim.”** – Transmetojnë Buhariu e Muslimi në Dy Sahihët e tyre nga Profeti, sal-lallahu 'alejhi ue sel-lem.

Ata thonë se zbatimi i urdhrave ose braktisja e ndalesave është në dobi të secilit zbatues dhe braktisës. Kurse, vetë urdhri dhe dërgimi i të dërguarve është dobi e përgjithshme për robërit, megjithëse mund të jetë dëm për disa prej tyre. Kështu edhe në çdo gjë tjetër që ka caktuar All-llahu dominon dobia, mëshira dhe përmirësimi, megjithëse për disa njerëz në të ka dëmtim, rreth të cilit All-llahu ka një urtësi tjetër.

Ky është mendimi i shumicës së fukahave, muhaddithinëve, sufijve dhe grupeve të kelmistëve, me përjashtim të mu'tezilijve – si kerramijtë dhe të tjerë. Të gjithë këta thonë se në disa prej krijesave të All-llahut ka dëm për disa njerëz, ose mund të jenë shkak për dëm, siç janë mëkatet, megjithatë secila prej tyre ka urtësi dhe dobi, për shkak të së cilës All-llahu e ka krijuar, dhe në secilën krijesë mëshira e All-llahut është mbi hidhërimin e Tij.

Këto çështje janë sqaruar gjerësisht në vende të tjera, kurse këtu përmenden vetëm në përgjithësi mendimet e grupeve dhe sqarohet se cili prej tyre është i saktë e cili gabim. Këtë që e ka transmetuar ai **(Ibnul Mutaḥḥar)**, nuk e ka transmetuar nga mësuesit e tij prej rafidijve, por ky është mendimi i mu'tezilijve, siç janë pasuesit e Ebu Aliut, Ebu Hashimit, Ebul Husejn elBasriut etj, të cilët këtë e kanë thënë duke e refuzuar elEsh'ariun në veçanti.

Esh'arijtë dhe disa të tjerë nga pohuesit e kaderit pajtohen me Xhehm ibën Safuanin në esencën e mendimit të tij rreth xhebrit, megjithëse kundërshtohen me të në disa çështje formale gjuhësore. Ata kanë sjellë fjalë të palogjikshme, por nuk pajtohen me të në mohimin e Cilësive. Ata i pohojnë Cilësitë.**(2)** Ata kanë shkuar deri në ekstrem gjatë kundërshtimit të mu'tezilijve rreth çështjeve të kaderit, saqë kanë arritur në mendimin e xhebrit, kanë mohuar se gjallesat kanë dëshirë dhe fuqi, kanë mohuar se ato kanë ndonjë ndikim ose janë shkak

në ndodhitë dhe kanë ndaluar të thuhet se ato janë veprues. Ata, gjithashtu, mohojnë se në krijimin e krijesave ekziston ndonjë urtësi ose arsye.

Prandaj thuhet se ata mohojnë që All-llahu i Lartësuar të bëjë diçka për sjelljen e dobisë për robërit e Tij, ose për largimin e dëmit prej tyre. Ata thonë se All-llahu nuk vepron diçka për dobi dhe se kjo nuk është obligim për Të dhe nuk ka nevojë të ndodhë prej Tij.

Ata thonë: **“All-llahu nuk bën një gjë për shkak të ndonjë gjëje ose për të arritur një gjë, por ato vijnë bashkë pse Ai dëshiron ashtu dhe e bën një gjë bashkë me një gjë tjetër, e jo për shkak të asaj ose për ta arritur atë. Ajo që dy gjëra vijnë bashkë është për shkak se Ai ashtu e ka zakon të veprojë, e jo se njëra prej tyre është shkak për tjetrën dhe jo se Ai ka urtësi në të.”**

...

Ehlus Sunneh e pohojnë kaderin dhe pohojnë, gjithashtu, urtësi dhe mëshirë. Ata thonë se secila vepër e All-llahut ka qëllim të dëshiruar dhe përfundim të lëvdur. Kjo është një çështje madhështore e cila është sqaruar në vende të tjera.

Në përgjithësi, nëse mu'tezilijtë dhe shiat pranojnë ndonjë lloj të urtësisë dhe mëshirës së All-llahut, Ehlus Sunneh pohojnë në mënyrë më të përsosur dhe më madhështore se ajo, duke e pohuar edhe fuqinë e plotë të All-llahut dhe dëshirën e Tij të pakufizuar që realizohet në krijesat e Tij. Kurse, mu'tezilijtë dhe shiat nuk e pranojnë këtë.” – përfundon citati i Ibën Tejmijs

Unë them: Analizojë mirë fjalën e Shejhul Islamit!

01 – Ai e sqaron medhhebin e kotë të kaderijve, të cilët e mohojnë më të mirën nga pushteti i All-llahut, e që është bindja dhe përulja e profetëve, melaikeve dhe besimtarëve, duke thënë se këtë All-llahu nuk e ka krijuar, nuk ka fuqi ta fusë robin e Vet në të, e as ta frymëzojë për të dhe se All-llahu nuk ka fuqi që mosvepruesin ta bëjë veprues. Pastaj sjell disa ajete kur'anore që janë argument për ta mposhtur kotësinë dhe devijimin e mendimit të tyre.

02 – Thotë: **“Sa i përket pohimit se Ai nuk e bën atë që është më e dobishme për robërit, ose se nuk kujdeset për mirëqenien e tyre, ky është një pohim rreth të cilit ka kundërthënie mes njerëzve.”** Pastaj e sqaron se kjo fjalë e kotë është mendimi i xhehmijve dhe pasuesve të tyre.

03 – Sqaron se xhumhuri i dijetarëve thonë se All-llahu i Lartësuar i ka urdhëruar robërit e Tij me urdhra që janë në dobi të tyre dhe ua ka ndaluar ato që janë në dëm të tyre, dhe se zbatimi i urdhrave është në dobi të përgjithshme

për atë që i zbaton dhe se dërgimi i të dërguarve është në dobi të përgjithshme, megjithëse ka dëm për atë që kundërshton dhe bën mëkate. Ai sqaron se zbatimi i urdhrit dhe braktisja e ndalesave është në dobi të atij që zbaton ose braktis.

04 – Ai, RahimehUllah, thotë: “Kurse, vetë urdhri dhe dërgimi i të dërguarve është dobi e përgjithshme për robërit, megjithëse mund të jetë dëm për disa prej tyre. Kështu edhe në çdo gjë tjetër që ka caktuar All-llahu dominon dobia, mëshira dhe përmirësimi, megjithëse për disa njerëz në të ka dëmtim, rreth të cilit All-llahu ka një urtësi tjetër. Ky është mendimi i shumicës së fukahave, muhaddithinëve, sufijve dhe grupeve të kelmistëve, me përjashtim të mu’tezilijve – si kerramijtë dhe të tjerë.”

Me këto fjalë ai sqaron se se në çdo ligj dhe caktim të All-llahut ka urtësi, si dhe sqaron se ky është mendimi i shumicës së fukahave, muhaddithinëve dhe të tjerëve.

05 – Pastaj, e përsërit pohimin e urtësisë së All-llahut në ligjet, caktimin dhe krijimin e Tij, si dhe se në krijimin dhe ligjet e tij ka urtësi dhe dobi, duke thënë:

“Të gjithë këta thonë se në disa prej krijesave të All-llahut ka dëm për disa njerëz, ose mund të jenë shkak për dëm, siç janë mëkatet, megjithatë secila prej tyre ka urtësi dhe dobi, për shkak të së cilës All-llahu e ka krijuar, dhe në secilën krijesë mëshira e All-llahut është mbi hidhërimin e Tij.”

E më vonë tregon se këto çështje janë sqaruar në vende të tjera nëpër libra.

06 – Ai, RahimehUllah, përmend se esh’arijtë dhe disa pohues të kaderit pajtohen me Xhehm ibën Safuanin në esencën e mendimit të tij rreth xhebrit, megjithëse kanë kundërshtime me të, të cilat janë kundërshtime formale. Sqaron se këta e mohojnë dëshirën dhe fuqinë e krijesave dhe mohojnë që krijesat të kenë ndikim ose të jenë shkak për disa ndodhi, si dhe ndalojnë që të thuhet se ata janë veprues të këtyre ndodhive. Shpjegon se ata e mohojnë urtësinë e All-llahut në krijim, e më pas sjell disa fjalë të devijuara të tyre.

07 – ...

08 – Më në fund thotë: “Në përgjithësi, nëse mu’tezilijtë dhe shiat pranojnë ndonjë lloj të urtësisë dhe mëshirës së All-llahut, Ehlu Sunneh pohojnë në mënyrë më të përsosur dhe më madhështore se ajo, duke e pohuar edhe fuqinë e plotë të All-llahut dhe dëshirën e Tij të pakufizuar që realizohet në krijesat e Tij. Kurse, mu’tezilijtë dhe shiat nuk e pranojnë këtë.”

Shiko, o lexues i nderuar, këtë imam! Sa e sa herë në këto fjalë të ndriçuara e pohon urtësinë e All-llahut në ligjet dhe caktimet e Tij! Sa e sa herë vërteton se ligjet e Tij ndërtohen mbi konsideratën e dobive dhe largimin e dëmeve! Të gjitha këto ua përshkruan imamëve të Sunnetit. Shiko se si i qorton grupet e devijuara në këtë temë!

Pastaj krahasoji fjalët e këtij imami dhe konkluzat e tij shkencore, të ndërtuara mbi Kur'anin dhe Sunnetit, me ato devijime dhe të kota që i përkrah dhe i miraton Halebiu, dhe kështu do ta kuptosh devijimin e këtij Halebiu dhe cektësinë e kuptimit të tij, i cili nuk e kupton dallimin mes dy të kundërtave.

Për këtë shkak Halebiu i referohet fjalëve të Shejhul Islamit, të cilat e shkatërrojnë të kotën dhe devijimin e tij, të xhehmijve dhe pasuesve të tyre nga të cilët është ndikuar Halebiu, ose pajtohet me ta për shkak të injorancës së tij rreth Kur'anit, Sunnetit dhe menhexhit të selefëve dhe imamëve të tyre.

Sa e sa herë ai përpëlitet nëpër pellgjet e injorancës, e kur të përkujtohet vetëm e shton kokëfortësinë dhe këmbënguljen në të kotë dhe mendjemadhësinë ndaj atyre që ia sqarojnë gabimin me qëllim që të përkujtohet dhe të frikësohet.

— Shënim i përkthyesit —

Më tej Shejh Rabi' ibën Hadi elMedkhali, All-llahu e ruajttë, përmend citate të gjata dhe argumente të shumta nga libri i Ibn Kajjimit Xheuzijes, RahimehUllah, përmes të cilave sqarohet në hollësi kjo çështje dhe vërtetohet se çdo gjë që ekziston – krijesat dhe veprat e tyre – është krijuar nga All-llahu Një; se çdo krijim dhe çdo urdhër i All-llahut përmban urtësi të plotë, ka qëllim fisnik dhe përfundim të dëshiruar; dhe se çdo vepër e All-llahut është për dobinë e krijesave dhe për largimin e dëmeve prej tyre.

Këto fjalë të Ibnul Kajjimit, RahimehUllah, do të mund të kuptohen vetëm nëse lexohen në arabisht, për shkak sqarimeve të shumta gjuhësore dhe retorike. Prandaj, po e shkurtoj artikullin duke mos i përkthyer këto fjalë, ngase edhe pa to artikulli është shumë i gjatë, kurse shqyrtimi i këtyre citateve është sa gjysma e asaj që u tha deri këtu.

Pas përpunimit dhe sqarimit të fjalëve të Ibnul Kajjimit, Shejhu e përfundon duke thënë:

Allahu e mëshiroftë! Imam Ibnul Kajjimin dhe ia dhëntë shpërblimin më të mirë për diturinë e bollshme dhe argumentet madhështore që ua ka ofruar njerëzve, të cilat ua shtojnë pasuesve të së vërtetës dijen dhe kuptimin dhe të cilat i mënjanojnë errësirat e injorancës dhe devijimit.

Në fund, e lus All-llahun e Madhërishëm që të na udhëzojë ne dhe muslimanët në përgjithësi në Rrugën e Tij të drejtë, të na përforcojë ne, nxënësit e dijes dhe

muslimanët në përgjithësi në Fenë e Vërtetë dhe të na mbrojnë të gjithë nga dëmi i thirrësve të fitneve! Ai është që i dëgjon lutjet.

Salavatet dhe selamet qofshin për të Dërguarin tonë Besnik, për familjen dhe shokët e tij në përgjithësi dhe për pasuesit e tyre në mënyrën më të mirë deri në Ditën e Gjykimit!

Fusnotat:

(1) - Domethënë: Xhehmijë dhe Mu'tezilijë.

(2) - Esh'arijtë pranojnë vetëm shtatë cilësi vetore, kurse cilësitë veprorë nuk i pranojnë.

Distancohem nga tekfiri i të pafajshmëve.

Autor: Salih ibën Feuzan elFeuzan, Anëtar i Asamblesë së Dijetarëve të Mëdhenj

Burimi: <http://www.alfawzan.af.org.sa/node/2349>

E gjithë lavdia I qoftë Vetëm All-llahut Një! Salavatet dhe selamet qofshin për atë pas të cilit nuk ka më profet tjetër, Profetin tonë Muhammedin, si dhe për familjen dhe shokët e tij! Më tej:

Më ka ardhur një pyetje, të cilën po e jap këtu tekstualisht bashkë me përgjigjen:

“Pyetja është rreth propagandës dhe thirrjes për mendimin liberal në vendet islame, që thërret për liri të plotë, të cilën e rregullojnë vetëm ligjet pozitive (njerëzore), e barazon muslimanin me të tjerët me pretendimin e pluralizmit, i jep liri personale secilit individ pa nënshtrim ndaj kornizave shariatike dhe kundërshton disa dispozita ligjore të Sheriatit, të cilat janë kontradiktore me të, siç janë dispozitat që kanë të bëjnë me gruan, raportet me jomuslimanët, ose ndalimin e të keqes, dispozitat e xhihadit... si dhe dispozita të tjera ku ka kontradikta mes liberalizmit dhe Islamit. A i lejohet muslimanit që të thotë: “Unë jam musliman liberal?”

Përgjigjja: Musliman është ai që I nënshtrohet All-llahut me teuhid, I përulet duke lu bindur Atij dhe distancohet prej shirkut (**paganizmit**) dhe njerëzve të tij (**paganëve**). Ai që dëshiron liri pa kufizime përveç kufizimeve të ligjeve pozitive, ai është rebeluar ndaj Sheriatit të All-llahut dhe e kërkon gjykimin e Xhahilijes (**kohës para Islamit**) dhe gjykimin e tagutit (**të adhuruarve të rremë**). I tilli nuk është musliman.

Ai i cili mohon prej Fesë diçka që dihet domosdoshëm (**që e di secili se është pjesë e Fesë**), siç është dallimi mes muslimanit dhe mosbesimtarit, dëshiron liri që nuk u nënshtrohet kornizave të Sheriatit dhe i mohon dispozitat ligjore të Sheriatit, ndër të cilat edhe dispozitat që kanë të bëjnë me gruan, urdhërimin për të mira dhe ndalimin e të këqijave dhe ligjshmërinë e xhihadit në rrugën e All-llahut, i tilli ka bërë disa anulues që ia anulojnë atij Islamin, të cilët i kanë përmendur dijetarët.

Ai, i cili thotë **“Unë jam musliman liberal”**, është kundërthënës me vetveten, nëse kuptimi i liberalizmit është ky që u përmend. **“I tilli është i detyruar të pendohet tek All-llahu, në mënyrë që të bëhet musliman me të vërtetë.”**

Kështu ishte përgjigjja ndaj pyetjes e cila ishte e caktuar. Përgjigjja nuk përfshiu asgjë përtej pyetjes. Por, kur pyetësi e publikoi përgjigjen, atëherë u bë zhurmë e madhe nga disa njerëz dhe këtë pyetje e klasifikuan në menhexhin e atyre që i quajnë **“tekfirista”**, të cilët i shpallin njerëzit kafirë–mosbesimtarë (**bëjnë tekfir**) pa të drejtë, sipas metodës së havarixhëve të devijuar.

Ata këtë përgjigje e zbatuan mbi disa njerëz që unë nuk i kisha për qëllim. Unë kisha për qëllim vetëm t'i përgjigjem pyetjes, ngase ajo që u përmend në pyetje është prej anuluesve të Islamit që janë të njohur te dijetarët. Unë, lavdi All-llahut, nuk shpika ndonjë fjalë nga vetja ime dhe unë distancohem tek All-llahu nga tekfiri i të pafajshmëve pa rregulla sheriatike.

Është e njohur se All-llahu i ka lidhur dispozitat me këta emra: m'umin (**besimtar**), kafir (**mosbesimtar**), munafik (**hipokrit**), fasik (**mëkatar**), muwehhid (**monoteist**) dhe mushrik (**pagan**). Ndërsa, **“sekularist”**, **“liberal”** dhe të ngjashme me to janë emra të rinj dhe nuk merret parasysh forma e fjalëve, por ajo që merret parasysh është kuptimi i saj dhe ajo se ç'shpërhej fjalë.

Nëse ndonjëra prej tyre e përmban kuptimin e asaj që e përmbajnë emrat sheriatik të lartpërmendur, atëherë asaj i jepet gjykimi sheriatik i tij, siç është kufri. Kufri mund të bëhet me besim, me fjalë, me vepër ose me dyshim. Këto çështje i kanë përmendur dijetarët në kapitujt e anuluesve të Islamit dhe në temat e gjykimit ndaj murteddit (**të dalin nga Feja**) në librat e fikhut.

Pastaj, ka dallim mes gjykimit ndaj fjalëve, veprave dhe besimeve në përgjithësi – kur thuhet: **“Kush beson, thotë ose bën kështu e kështu është kafir – dhe**

gjykimit ndaj individëve. Nuk është kafir secili që thotë ose bën kufr, deri sa të realizohen tek ai kushtet dhe të mënjahen pengesat.”

Nëse njeriu nga i cili kanë dalë këto kufre ka qenë i detyruar, injorant, keqinterpretues ose pasues i atij për të cilin ka menduar se është në të drejtë, atëherë nuk nxitohet për t’ia dhënë atij gjykimin e kufrit, deri sa ta shqyrtojmë çështjen e tij.

Të tillin e ka justifikuar All-llahu i Madhërishëm dhe i Lartësuar, kur ka thënë:

“مِنَ اللَّهِ وَلَهُمْ كُفْرٌ صَدْرًا فَعَلَيْهِمْ عَذَابٌ مِّنْ كَفَرٍ بِاللَّهِ مِنْ بَعْدِ إِيمَانِهِ إِلَّا مَنْ أَكْرَهَ وَقَلْبُهُ مُطْمَئِنٌّ بِالْإِيمَانِ وَلَكِنْ مَنْ شَرَحَ بِالْإِثْمِ عَذَابٌ عَظِيمٌ”

“Kushdo që mohon All-llahun, pas pranimit të besimit, me përjashtim të atij që është i detyruar me forcë, ndërkohë që zemra e tij është plot besim; por ata që ia hapin zemrën mosbesimit, do të kenë mbi vete zemërimin e All-llahut dhe një dënim të madh.” (enNahl: 106)

Injorantit, keqinterpretuesit dhe pasuesit u sqarohet dhe u qartësohet. Nëse këmbëngulin në atë që e bëjnë, atëherë gjykohen për kafirë, ngase pengesat janë mënjauar. All-llahu i Lartësuar thotë:

“مَ لَسْتُ مُؤْمِنًا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِذَا ضَرَبْتُمْ فِي سَبِيلِ اللَّهِ فَتَبَيَّنُوا وَلَا تَقُولُوا لِمَنْ أَلْفَىٰ إِلَيْكُمْ السَّلَامَ يَا”

“O besimtarë! Kur të shkoni në luftë, në rrugë të All-llahut, shqyrtoni gjithçka me kujdes! Mos i thoni atij që ju përshëndet me selam: “Nuk je besimtar”...” (enNisa’: 94)

Domethënë se ai që e shfaq Islamin dhe i shqipton dy dëshmitë duhet të lihet i lirë, ngase ai është bërë musliman dhe kështu llogaritet deri sa të shfaqet prej tij diçka që ia anulon atij Islamin. Në atë rast gjykohet se ka bërë ridde, nëse nuk ka ndonjë nga arsyet që u sqaruan më lart.

Pastaj, nuk lejohet assesit që dikush të shpallet për kafir vetëm në bazë të thashethemeve. Mund të shpallet vetëm nëse ai vetë e miraton, ose në bazë të dëshmisë së njerëzve të besueshëm për diçka që ka dalë prej tij, pas vërtetimit të plotë se ai nuk është i arsyetuar me ndonjërin nga arsyet e lartpërmendura.

All-llahu thotë:

“يَبُوءُ قَوْمًا بِجَهَالَةٍ فَتُصْبِحُوا عَلَىٰ مَا فَعَلْتُمْ نَادِمِينَ يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِنِ جَاءَكُمْ فَاسِقٌ بِنَبَأٍ فَتَبَيَّنُوا أَنْ تُصِيبُوا قَوْمًا بِجَهَالَةٍ فَتُصْبِحُوا عَلَىٰ مَا فَعَلْتُمْ نَادِمِينَ يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا إِنِ جَاءَكُمْ فَاسِقٌ بِنَبَأٍ فَتَبَيَّنُوا أَنْ تُصِيبُوا قَوْمًا بِجَهَالَةٍ فَتُصْبِحُوا عَلَىٰ مَا فَعَلْتُمْ نَادِمِينَ”

“O ju që keni besuar! Nëse ndonjë njeri i pandershëm ju sjell ndonjë lajm, sigurohuni mirë (në është i vërtetë), për të mos i bërë dëm ndokujt pa dashje, e të pendoheni pastaj për atë që keni bërë.” (elHuxhurat: 6)

Vetëm dijetarët e thelluar në dije janë ata që kanë kompetencë për dhënien e gjykimeve mbi njerëzit të cilët kanë shfaqur diçka që e cungon akiden e tyre, siç janë anuluesit e Islamit. Nuk ka të drejtë secili injorant ose secili që mëson ta marrë përsipër këtë çështje, ngase ka dallim mes gjykimit të përgjithshëm dhe gjykimit ndaj individit, siç u theksua më lart.

Kush gjykon në këto çështje pa dituri, ai është në rrugën e havarixhëve të devijuar, të cilët i shpallin muslimanët për kafirë dhe e bëjnë të lejuar derdhjen e gjakut të tyre dhe marrjen e pasurive të tyre, mu ashtu siç na ka lajmëruar Profeti, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem. All-llahu na ruajttë nga metoda e tyre dhe kërkojmë prej All-llahut që t'i mbrojë muslimanët nga sherri i tyre!

Çështja e tekfirit është çështje e vështirë dhe e rrezikshme. Prandaj dijetarët e kanë përmendur në librat e akides dhe në librat e fikhut, në mënyrë që të mësohet dhe t'u sqarohet njerëzve.

Kjo çështje, lavdi All-llahut, gjendet edhe në plan-programet mësimore **(në Arabinë Saudite)**, në mënyrë që t'u shpjegohet dhe qartësohet nxënësve, me qëllim që të mos rrëshqasin bashkë me njerëzit e devijimit për shkak të kuptimit të gabuar, siç u ka ndodhur havarixhëve.

Nga ky rrezik – rreziku i tekfirit pa dituri – mund të mbrojë vetëm mësimi i akides së drejtë tek dijetarët e specializuar për të.

Siç ekzistojnë të atillë që i shpallin njerëzit për kafirë me injorancë, njashtu ekzistojnë edhe të atillë që janë në ekstremin e kundërt, duke thënë se askush nuk bëhet kafir, pa marrë parasysh se çka thotë, çka bën dhe çka beson.

Këta, gjithashtu, i kundërshtojnë tekstet e Kur'anit dhe Sunnetit, të cilat e sqarojnë se me cilat fjalë, vepra ose besime njeriu bëhet murtedd.

Të dy grupet – tepruesit dhe cunguesit – kanë nevojë që ta mësojnë akiden e drejtë tek dijetarët e specializuar, ose në mësimet brenda sistemit – në shkolla, institute ose fakultete, ose në mësimet e dijes, të cilat mbahen nëpër xhami.

Kujdes, kujdes nga marrja e mësimi prej librave, ose prej atyre që shtirren si dijetarë, prej të panjohurve ose në vende të fshehta. All-llahu i Lartësuar ka paralajmëruar për rriden dhe daljen nga Islami dhe e ka qartësuar rrezikun e saj në Librin e Tij Fisnik.

Ai thotë:

”قُوا اللَّهَ حَقَّ تَقَاتِهِ وَلَا تَمُوتُنَّ إِلَّا وَأَنْتُمْ مُسْلِمُونَ يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ

“O besimtarë! Kijeni frikë All-llahun ashtu si I takon Atij dhe vdisni vetëm duke qenë myslimanë!” (Ali Imran: 102)

“الْآخِرَةُ مِنَ الْخَاسِرِينَ وَمَنْ يُكْفَرْ بِالْإِيمَانِ فَقَدْ حَبِطَ عَمَلُهُ وَهُوَ فِي

“Kushdo që mohon besimin, veprat e tij do të zhvlerësohen dhe në jetën tjetër ai do të jetë i dështuar.” (elMaide: 5)

نُيَا وَالْآخِرَةُ وَأُولَئِكَ أَصْحَابُ النَّارِ هُمْ فِيهَا وَمَنْ يَزِدْ مِنْكُمْ عَنْ دِينِهِ فَيَمُتْ وَهُوَ كَافِرٌ فَأُولَئِكَ حَبِطَتْ أَعْمَالُهُمْ فِي الدُّ
“خَالِدُونَ”

“Ata nga mesi juaj që e mohojnë Fenë dhe vdesin si mohues, – veprat e tyre (të mira) do të humbasin në këtë botë dhe në tjetrën. Ata do të jenë banorë të Zjarrit, ku do të qëndrojnë përgjithmonë.” (elBekara: 217)

Askush nuk është i siguar për veten e tij nga riddeja, sidomos në kohën e shtimit të fitneve, siç është koha jonë. Profeti, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ka thënë:

مُؤْمِنًا وَيَمْسِي كَافِرًا وَيَصْبِحُ كَافِرًا يَبِيعُ دِينَهُ بَعْرَضٍ بَادِرُوا بِالْأَعْمَالِ فِتْنًا كَقَطْعِ اللَّيْلِ الْمَظْلَمِ يَصْبِحُ الرَّجُلُ
“مِنَ الدُّنْيَا

“Nxitoni me vepra të mira! Po afrohen fitne si pjesët e errëta të natës. Në to njeriu gdhiet besimtar dhe ngryset mosbesimtar; ose ngryset besimtar dhe gdhiet jobesimtar. E shet Fenë e vet me një ofertë të vogël të Dunjasë.”

Për shkak të rrezikut të fitneve dhe riddes – daljes prej Islamit, as Ibrahim – miku i All-llahut, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, nuk është ndjerë i sigurt për veten e tij. Ai ka thënë:

“وَبَنِيَّ أَنْ نَعْبُدَ الْأَصْنَامَ وَاجْتَنِبِي”

“Më ruaj mua dhe pasardhësit e mi nga adhurimi i idhujve!” (Ibrahim: 35)

Profeti ynë Muhammedi, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ka thënë:

“يَا مَعْزِلُ الْقُلُوبِ وَالْأَبْ صَارَتْ قُلُوبِي عَلَى دِينِكَ”

“O Rrotullues i zemrave dhe shikimeve, përforcoma zemrën në Fenë Tënde!”

Atëherë Aisha, radijAll-llahu anha, kur e ka dëgjuar i ka thënë: **“A ke frikë, o i Dërguari i All-llahut!”** Ai, sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem, ka thënë:

“يَا عَائِشَةُ وَمَا يَوْمَنِي وَالْقُلُوبُ بَيْنَ أَصْبَعَيْنِ مِنَ الرَّحْمَنِ”

“Oj Aishe! Ç’më siguron mua, kur zemrat janë mes dy gishtave të të Gjithëmëshirshmit!?”

Mu për këtë shkak njerëzit e thelluar në dije thonë:

“رَبَّنَا لَا تُزِغْ قُلُوبَنَا بَعْدَ إِذْ هَدَيْتَنَا”

“O Zoti ynë! Mos na i devijo zemrat pasi na udhëzove!” (Ali Imran: 8)

O All-llah! Na i përforco zemrat tona në Fenë Tënde dhe ruana nga sherri i fitneve! Salavatet dhe selamet qofshin për Profetin tonë Muhammedin, për familjen dhe shokët e tij!

Kush jane Ahmedit apo Kadijanit!

Pergatiti: Hoxhë Besim Gjellaj

Biografi e shkurter rreth ahmedive-kadijanive

Kadijanizmi konsiderohet si vazhdimësi e ideologjive të cilat mohojnë përfundimin e pejgamberisë me ardhjen e Muhammedit sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem.

Është një prej levizjeve të shumta devijuese, fillet e së cilës janë në inkubatoret e armiqve të islamit, natyrishtë nën perkujdesjen dhe këshillat e tyre. Quhet el-Kadijanije bazuar në emrin e fshatit Kadijan, fshat i cili gjindet në krahinen e Penxhabit në Indi, ku ka lindur themeluesi i këtij fraksioni. Fshati Kadijan më heret është njohur me emrin IslamBur e më vonë e ka marrë emrin Kadijan. Ky fraksion njihet edhe me emrin el-Ahmedije, bazuar në emrin e themeluesit të këtij grupi. **“Dijetari Ihsan Dhahiri rahimehullah thotë: “Kadijanitë në Afrikë si dhe në vende tjera e quajnë vetën Ahmedit me qëllim për të mashtruar muslimanët, edhe pse në realitet nuk kanë lidhje me të Dërguarin Muhammed sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem, që njëri prej emrave të tij është edhe Ahmed, kurse emri i “profetit” të tyre është Gulam Ahmed el Kadijanu, ku me këtë emër janë të njohur në Pakistan dhe Indi.”**

Themeluesi i Kadijanizmi:

Themeluesi i Kadijanizmit është Gulam Ahmed bin Gulam Murteda el Kadijanu. Sa i përket preardhjes së tij, ka shumë variante bazuar në dëshmit e

tij, herë na paraqitet si Mongolian e herë si Persian. Ka lindur në vitin 1839 ose 1840, në fshatin Kadijan, krahina e Penxhabit.

Qysh ne moshë të re mesoj sintaksen, morfologjinë dhe disa libra arabe dhe perisane, por për fat të mirë nuk patë sukses në marrjen e diturisë. Po ashtu e mesoj gjuhen angleze sepse ishte i nevojshëm, ngase punonte me të atin në shërbim të anglezve.

Sa i perket familjës së tij, ka qenë familje e njohur si familje e ndershëm ndaj armiqve, posaçërisht anglezve. Ketë na e vërteton gjenerali Nikolson ku thotë: **“Familja e Mirza Gulam Ahmed el-Kadijaniut, dallohet nga gjitha familjet tjera sa i perket shërbimit ndaj anglezve...”** {Egashursh Keshmiri, ‘Havnetul-islam’ f.3-4}

Prej thënjeve të tij -kadijaniut- që dëshmojnë miqësinë e tij ndaj kundërshtarëve të islamit veqojmë: **“Shumicën e jetës sime e kam kaluar në perkrahjen e qeverisë angleze dhe e kam ndihmuar, vetëm se kam shkruar për degradimin e xhihadit, si dhe obligimin e peruljes ndaj pushtetit anglez, në libra, shpallje dhe revista...”** {Terjakul-kulub, e kadijaniut, f.15}.

Morali i tij ishte i ulët, ka qenë gjuhëndytur, ofëndues dhe frikacak. Aq shumë ka qenë i topitur-kokëtrashë sa që nuk e ka dalluar mbathesën e djathtë nga e majta, për këtë ka vendosur një shënjë në mbatheset e tij kështu që mos ta fus këmbën e majte në mbathesën e djathtë... {el-Kadijanije, Ihsan Dhahiri, f.139-146}.

Përfundimi i tij: **Është semur në Lahor, nga një sëmundje epidemike që i përngjan kolerës, e shoqëruar me vjedhje dhe barkqitje për një kohë të gjatë, kështu që shumica e kohës i ka kaluar në WC. Si shkak i sëmundjes së rëndë ndytësiat i kan dalë nga goja para vdekjes, deri sa ka ndërruar jetë në vend të ndytë.** {el-Kadijanije, Ihsan Dhahiri, f. 158-180}.

Parimet e kadijanive:

01 - Mohimi i asaj që është transmetuar në Kur'an dhe sunnet që Pejgamberi Muhammed sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem është i dërguari i fundit, vulë e pejgamberisë; All-llahu i lartësuar thotë: **“Muhammedi nuk ka qenë babai i asnjërit prej burrave tuaj por ai ishte i dërguar i Allahut dhe vulë e të gjithë pejgamberëve”** {Ahzabë 40}. Dijetarët janë të pajtimit se ai që mohon vetëm një shkronjë në Kur'an është pabesimtarë.

02 - Mohimi i lindjes së Isait alejhis-selam prej nënës pa baba, pohojnë që ka babë, dhe e përgënjeshtrojnë Allahun e lartësuar: **“Vërtët, qështja e Isait (të lindur pa baba) tek All-llahu është sikurse qështja e Ademit. Atë e krijoi Ai nga dheu, e pastaj atij i tha: “Behu!” ai u bë”** {Ali Imran 59}. Kjo aludon në mosbësimin e tyre, në përgënjeshttrimin e Kur'an-it, në shpifje ndaj Merjemes

alejhas-selam nga ajo që e ka pastru All-llahu prej saj, duke ra dakord me hebrejët në këtë qështje.

03 - Bindja se All-llahu i lartësuar nuk e ka ngrit Isaun sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem pranë Vetës, keshtu që e pergënjëstrojnë All-llahu e lartësuar ku thotë: **“Po ata as nuk e mbytën as nuk e kryqëzuan, por atyre u përngjau. Ata që nuk u pajtuan rreth (mbytjes së) tij, janë në dilemë për të (për mbytje) e nuk kanë për të kurrfarë dije të saktë, përveç që iluzojnë. E ata me siguri nuk e mbyten atë. Përkundrazi, Allahu e ngriti atë pranë Vetës. Allahu është i plotfuqishëm, i dijshtëm”** {Nisaë 157-158}.

04 - Mohimi i mrekullive te pejgamberve të cilat janë mutevatire, të cekuara në Kur'an në shumë vënde siç janë ne tregimet e Salihut, Musait, Isait dhe Muhammedit salAll-llahu ue sel-leme alejhim exhmein.

05 - Pretëndimi se kinse xhihadi i cekur në Kur'an dhe Sunnet është degraduar, edhe pse të gjithë dijetarët janë të pajtimit se xhihadi është i perhershëm, dhe është vaxhib kifai'i për muslimanët, dhe është obligim ajni'i në disa raste.

06 - Pretëndimi i Kadijaniut kinse është Mehdiu dhe Isau biri i Merjemës, si dhe pranimi i kësaj ideje nga besimtarët e tij.

07 - Armiqësia e madhe e tyre ndaj muslimanve, si dhe miqësia e tyre ndaj pabesimtarve.

Selefizmi dhe dëlirësia e zemrave.

Autor: Shejh Sulejman er-Ruhajli

Burimi: <http://www.ajurry.com/vb/showthread.php?t=36872>

Prej të folurit rreth mirësive të Allahut mbi ty, është që të shfaqësh pa krekosje.. dhe kjo gjë është jashta mësimit, mirëpo është një çështje që duhet ta vërejmë tek sjellja jonë me fqinjët tanë, vëllezërit tanë dhe njerëzit; sepse kjo Fe është e çuditshme o vëllezër!

Kjo Fe i ruan zemrat, i ruan zemrat që të jenë të shëndosha, të pastra, të kthjellëta, të jenë të bashkuara dhe mos të ketë përçarje mes tyre, përveçse me

një shkak fetar që e kërkon këtë gjë; dhe tek kjo gjë nxënësit e dijes duhet të tregohen të vëmendshëm.

Fatkeqsisht disa prej nesh tani, u shtohet dituria dhe i pakësohet dëlirësia e zemrës së tij. Sa herë që i shtohet dituria, po aq i pakësohet dëlirësia e zemrës; dhe ky është një problem.

Ajo që kërkohet prej teje, është që sa herë ta shtosh diturinë, ta shtosh dëlirësinë dhe pastërtinë e zemrës tënde.

Duhet të largohesh nga gjërat që shkaktojnë largimin e zemrave, përveç nëse Allahu e dëshiron një gjë të tillë prej teje. Përpiku **(të ruash)** gjuhën tënde, kështu që mos përcill diçka që i përçanë zemrat kurrësesi, përveç nëse kjo kërkohet prej teje fetarisht.

Edhe nëse dëmtohesh, përpiku që mos t'i largosh zemrat, sepse ky është ndikimi i diturisë, ky është pastrimi i diturisë; sidomos ne o vëllezër. Ehli Suneti në çdo kohë janë të pakët, dhe ata në këtë kohë janë edhe më pak, kështu që ne duhet të përpiqemi t'i bashkojmë zemrat në të vërtetë përmes të vërtetës, dhe të largohemi nga çdo gjë që i largon zemrat e njerëzve të të vërtetës nga njëri-tjetri.

Për këtë, ne jemi njohur me përpjekjen e dijetarëve tanë në bashkimin e zemrave, me durim dhe përkujdesje; përveç në rastin kur Sheriati e kërkon **(të kundërtën)**, ue la haula ue la kuvvete il-la bil-lah! Kështu duhet vepruar.

Pasha Allahun! Unë gjithnjë e them o vëllezër: selefizmi është më e çmuar dhe e bukur sesa çështjet tona personale, **(dhe si e tillë)** ai meriton prej nesh që të lëshojmë shumë prej të drejtave tona për shkak të kësaj karakteristike madhështore, në mënyrë që të bashkojmë zemrat rreth tij **(rreth selefizmit)**. E nëse pozicioni kërkon diçka prej kritikës, ath le të bëhet në një formë që nuk i largon zemrat dhe të përdorim metodat e mira.

Pasha Allahun! Prej dijetarëve tanë kemi parë një durim prej dhjetë apo njëzet vjetëve me qëllim mos-largimin e zemrave. Bile ai që i përkatësohej selefizmit gabonte, dhe dijetari bënte durim ndaj tij, dhe nuk e shfaqte atë nga frika se mos ai bënte kthesë e më pas të kritikohej përmes tij në të ardhme në formë Sheriatike, dhe me rrugë Sheriatike të saktë.

Kjo Fe është Fe e zemrave o vëllezër! Pasha Allahun, nuk ka hajër në një dituri e cila nuk sjell në zemrat tona pastërtinë dhe dëlirësinë. UAllahi, uAllahi dhe uAllahi, vërtetë selefizmi është dëlirësi.

O vëllezër, selefizmi është udhëzim, siguri, selefizmi është rruga e drejtë e Allahut. Është udhëzim uAllahi është udhëzimi më i madh, siguri për njeriun dhe për vëllezërit e tij.

Për këtë o vëllezër, ne duhet të tregohemi të vëmendshëm rreth kësaj. Kjo është prej urtësive që ka ndalesa e ngrënies dhe pirjes në enë prej floriri dhe argjendi, në mënyrë që ato mos t'i thyejnë zemrat; sepse kjo Fe është Fe e zemrave, dhe ne duhet të tregohemi të vëmendshëm rreth kësaj çështje.

Kërkojmë strehim tek Allahu nga të qëniet prej atyre që gjuhët i kanë të këndshme, ndërsa zemrat i kanë të ndotura. Pasha Allahun, nuk ka hajër në këtë, edhe sikur njeriu të lartësohet **(në pozitë)**. UAllahi, uAllahi, të jesh i panjohur me një zemër të dëlirë, me një zemër të “shëndoshë”, është më mirë për ty sesa të jesh një flamur valëvitës me zemër të prishur, me çfarëdo lloj prishjeje që Allahu azze ue xhel-le nuk e don kurrësesi, dhe nuk është i kënaqur që robi i Tij ta ketë në zemër.

Nga shprehjet e pa qarta.

Autor: Shejh Muhamed Bazimul, hafidhahUllah

Burimi: (Ibarat Mevhemeh f.57-58)

Thënia e disave: **“Ky dijetar nuk është nga dijetarët e mëdhenj”**

Këtë thënie shpesh e përsërisin disa njerëz kur dëshirojnë ta refuzojnë ndonjë fjalë që e kanë thënë dijetarët, apo kur dëshirojnë ta largojnë dike nga dëgjimi i këtij dijetari, apo marrja e diturisë prej tij, posaçërisht nëse çështja është nga lloji i ndalimit nga e keqja, paralajmërimi nga bidati dhe dhënia e vërejtjes për ndonjë gabim.

Kjo është e kotë, është nga cytjet e djallit, i cili mundohet ta largoj njeriun nga dëgjimi i të vërtetës apo pranimi i saj. Pra, kjo është thënie e pa pranuar në shumë aspekte:

E para: Parimisht nuk refuzohen fjala për shkak të personave, por pranohet fjala dhe refuzohet varësisht prej pajtueshmërisë së saj me të vërtetën dhe varësisht prej kundërshtimit të saj me të kotën. Nëse bie në pajtim me të vërtetën e pranojmë, e nëse e kundërshton të vërtetën e refuzojmë.

Kurse, të refuzohet fjala e dikujt veç pse ai nuk është nga dijetarët e mëdhenj, nuk bën, për shkak së me këtë refuzohet parimi në esencë, e ai është: E vërteta nuk njihet me burra.

E dyta: Nëse personi është nga dijetarët e mëdhenj nuk do të thotë që fjala e tij është hak, po ashtu personi që nuk e ka arrit shkallën e dijetarëve të mëdhenj

nuk do të thotë gjitha fjalët e tij janë të kota (**Batil**), siç transmetohet nga imam Maliku, RahimehUllah: **“Nuk ka asnjë prej nesh, përveç së refuzues dhe të refuzuar (nuk i merret fjala), me përjashtim këtij njeriu në varr (ka pas për qëllim Pejgamberin sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem).”**

Çështjen e ka kthyer tek shikimi në argument i thanësit dhe pajtueshmërisë së tij me të vërtetën apo të kundërtën e kësaj.

E treta: Kjo thënie ndikon që njerëzit të largohen nga dijetarët dhe të humben të drejtat e dijetarëve, përderisa dijetari nuk është i njohur tek ta, apo ata nuk i kushtojnë rëndësi atij, apo dijetari nuk është i njohur.

E katërta: Kjo thënie ka elemente të edukatës së mangët sa i përket hakut me dijetarët, kurse, duhet të ruhet nderi i tyre, si dhe çështja është varësisht prej gjendjes së tyre duke u bazuar në Kur'an dhe Sunet sipas asaj që ishin Selefi.

E pesta: Kjo thënie tanimë është nga gjërat shkatërruese tek bidatçitë, përmes saj e refuzojnë fjalën e Ehklusunetit dhe Xhematit. Sa që çdo fjalë e dijetarit që paralajmëron nga bidati që kanë ra në të, apo nga gabimi që ata e veprojnë, ata e mbrojnë fjalën e tyre dhe paralajmërojnë nga fjala e dijetarit me pretekst së ai nuk është nga dijetarët e mëdhenj.

Andaj, është obligim të refuzohen bidatçitë dhe të paralajmërohet prej metodologjive të tyre, që përmes tyre e luftojnë hakun dhe pasuesit e tij.

E gjashta: Kuptimi i kësaj thënie është: Nuk ka të drejtë në refuzimin e gabimit, në të cilin kanë ra këta që quhen Thirrës (**Duat**), qofshin individ apo grupe, me përjashtim nëse (**ai që i refuzon**) është tek ta prej dijetarëve të mëdhenj!

Kjo nuk është e vërtetë, në përgjithësi bie në kundërshtim me fjalën e Pejgamberit sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem: “Kush prej juve sheh ndonjë të keqe, le ta largoj me dorën e tij, e nëse nuk mundet, atëherë me gjuhen e tij, e nëse nuk mundet, atëherë me zemrën e tij, porse ky është imani më i dobët”.

E shtata: Allahu i lartësuar ka urdhëruar për t'i pyetur dijetarët që mbështeten në Kur'an dhe Sunet (**ata që janë përkujtues**) dhe nuk e ka bërë kusht të jenë të njohur apo prej dijetarëve të mëdhenj, për këtë ka thënë i Lartësuari: **“Ne as para teje nuk dërguam tjetër, përveç burra, të cilëve u dhamë shpallje. Andaj, pyetni dijetarët e Librit nëse ju nuk e dini. (I patëm dërguar) Me argumente e me libra të shenjtë. Ty ta zbitem Kur'anin që t'u shpjegosh njerëzve atë që u është shpallur atyre, me shpresë që ata të mendojnë”** (Nahl 43-44).

E teta: Kur dijetari ta cek ty bidatin apo gabimin e këtij apo atij njeriu që ka renë në të, ai të tregon për gjendjen e tij, kurse lajmi i të besueshmit është i

pranuar **(makbul)**, përveç nëse e kundërshton një tjetër po ashtu i besueshëm sikur ai. Dhe në këtë çështje nuk kushtëzohet që njeriu të jetë nga dijetarët e njohur apo te jetë prej dijetarëve të mëdhenj.

Pra, këtë nuk e ka potencuar askush prej dijetarëve në rregullat e pranimi të lajmit, kurse pohimi i kësaj është dalja nga ajo që e kanë pohuar dijetarët.

E nënta: Gjendja reale e këtij thanësi tregon së ai dëshiron miratimin e bidatit dhe mos urrejtjen e tij. Sepse, ti edhe nëse i sjell atij fjalët e dijetarëve të mëdhenj kundër këtij bidati, apo kundër kësaj thënie të kotë, apo në lidhje me sqarimin e gabimit të këtij njeriut ose dikujt tjetër, ai po ashtu nuk e pranon, mirëpo do të përdor mënyrë tjetër për ta refuzuar, siç është:

O vëllai im, ky shejh po ndikohet nga ata që janë për rreth tij!

Apo o vëllai im, mos hulumtoni në akidën e njerëzve dhe në gabimet e tyre!

Apo o vëllai im, hedhja poshtë e atyre që janë me famë nuk është gjë e lehtë!

Apo thotë: Unë nuk jam i detyruar ta pasojë fjalën e shejhut, apo përdor shprehje të ngjashme.

Rezultat i gjithë kësaj është:

E kota **(batili)** vazhdon. Vazhdon thirrja për tek ky njeri dhe bidati i tij. Vazhdojnë **(me punën e tyre)** thirrësit e së kotës dhe kjo behët në emër të sunetit dhe pasuesve të tij! Mashtrohen njerëzit, deri në atë masë sa që njerëzit nuk i njohin pasuesit e së vërtetës dhe nuk e kërkojnë të vërtetën që gjendet tek ta. Pastaj, njerëzit nuk e njohin sunetin, konsiderohet e mirë e keqja, kurse, e keqja e mirë! Nuk ka mundësi e as forcë askush tjetër pos Allahut, vërtetë të Allahut jemi dhe tek Ai kthehemi!

Vëllazëria e dështuar dhe akuzat e tyre ndaj dijetarëve!

Autor: Shejh Muhamed ibën Hedi el-Med'hali, hafidhahUllah.

Burimi: <http://www.sahab.net/forums/index.php?showtopic=131289>

Vëllazëria muslimane i akuzojnë dijetarët e thirrjes selefite me shpifje gjë që ata janë të pastër prej tyre, i akuzojnë për bashkëpunim me pushtetarë! Në realitet ata janë bashkëpunëtorë të pushtetarëve, po ashtu i akuzojnë dijetarët për afërsi më pushtetarë! Kurse ata vet janë afër pushtetarëve, dhe ata vet janë ata që iu bëjnë dredhi pushtetarëve!!

Këta janë tamam ashtu siç ka thënë shejh Hamid Fekij, RahimehUllah:
“Tradhtarët musliman.”

I akuzojnë dijetarët me akuza të tilla! Kurse dijetarët e islamit, dijetarët e thirrjes selefite nuk thonë asgjë përveç së duke u bazuar në librin e All-llahut dhe në Sunetin e të Dërguarit sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem.

Pushtetari i takon tri kategorive:

01 - Pushtetarë i drejtë dhe i mirë;

02 - Musliman, mirëpo ka disa gabime, bënë padrejtësi dhe krime;

I pari: çështja e tij s’ka nevojë për diskutim, **I dyti:** nuk lejohet kryengritja kundër tij për shkak të padrejtësive dhe krimeve që i bën ai, por duhet përmbushur obligimin ndaj tij të cilin na e ka bërë obligim All-llahu, e nëse na privon nga e drejta e jonë, atëherë i kërkojmë All-llahut të madhërishëm të drejtën tonë.

03 - pa besimtarë, kufri i tij shihet dukshëm, nuk ka mundësi interpretimi apo ndonjë dyshim, por qartë dihet që ai është pa besimtarë, në këtë rast i Dërguari i All-llahut sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem ka lejuar luftimin kundër tij, mirëpo kur? Kur forca ekziston për ta luftuar.

Më lejoni të ju them diçka -të nderuar vëllezër dhe bijë- ndoshta disave fjalimi nuk do të i pëlqejë! Mirëpo unë inshe All-llah nuk mendoj për juve ndryshe përveç së mirë, ju po e shihni në çdo vend ku ata kanë arritur, siç po e quajnë pranvera arabe!

Në realitet ajo është pranvera e vëllazërisë nëse bën ta quaj kështu- me çifutë, krishterë, sekularista, komunistë dhe me liberalet!!

Po ju përkujtoj me një gjë, ata vet thonë: **“Dhe kush nuk gjykon me atë që e ka zbrit All-llahu”** kjo është fjala e All-llahut, **“Të tillët janë pa besimtarë”**, **“Mospërfillës”** dhe **“Të padrejtë”**, tri ajete, kurse tefsirin e Ibën Abbasit radijAll-llahu anhu në lidhje me këto ajete e refuzojnë, kurse tek ne tefsiri i tij është si sytë e ballit, All-llahu qoftë i kënaqur më të, e refuzojnë dhe nuk donë asgjë tjetër vetëm së t’i konsiderojnë pushtetarët pa besimtarë, pse?!

Sepse ata nuk po gjykojnë me ligjin e All-llahut!! – Me she All-llah- mirë.

Prijësit e tyre në Evropë, para së të vinin në vendet muslimane, në deklaratat e tyre të para pohuan duke thënë: **“Nuk është islami vetëm Xhild (ndëshkim me kamxhik), Rrexhm (gurëzim) dhe prerje dorës (në rast të vjedhjes)!!”**

Do të thotë prerja e dorës, goditja me kamxhik kur bën zina, kur konsumon verë apo akuzon dikë pa fakte, si dhe gurëzimi i të martuarit të mos aplikohen!

Më një fjalë nuk paska zbatim të ligjit të sheriatit! –Me she All-llah- ky është sheriat i ditës së sodit – që dje - për shkak të tij i konsideronit pushtetarët pa besimtarë ngase ata nuk gjykonin me ligjin e All-llahut!!

Tashmë ju ndryshuat mendimin pasi ju arritët pushtetin!!

Në rrugë duke ecur, në udhëtim nga vendet e Evropës, të drejtuar ka vendet e juaja dhe thoni: **“Nuk është islami vetëm Xhild (ndëshkim me kamxhik), Rrexhm (gurëzim) dhe prerje dorës (në rast të vjedhjes)!!”**

Tjetra, njëri prej tyre thotë: **“Unë e favorizojë praktikimin e ligjeve demokratike para ligjeve të sheriatit!!”**

Me she All-llah!! Kurse ti dje ishe ai që në Mejdanin e Tahririt, ishe duke thirrur në kryengritje, i thirrshë të tjerët në kryengritje kundër pushtetarëve!!

Dje, këta ishin ata që thanë: **“Pushtetarët janë bashkëpunëtorë të çifutëve dhe të krishterëve!!”**

Kurse tani, menjëherë pasi që mbërrijnë në vendin e tyre thonë: **“Do t’i përmbahemi marrëveshjeve me çifutët!!”**

Cili është dallimi mes juve dhe atyre që ishin para jush?!! Nëse ata që ishin para juve ishin pa besimtarë për shkak të këtyre gjërave, sipas fjalëve tuaja, që ju gjykuat ndaj të tjerëve, po ashtu gjykohet edhe ndaj juve.

Në vendet e Shamit, në vendet e Shamit njëri prej tyre deklaroi, janë mbushur gazetatat dhe regjistrat me deklarata të tilla, që tek ta, tek Vëllazëria Muslimane, po citoj shkronjë për shkronjë! Nuk ka pengesë që ata t’i udhëheq ndonjë i krishterë apo ndonjë grua!!

Kjo gjendët në gazeta, në mediat publike me gjitha llojet e saj, qofshin ato që dëgjohen apo që janë të shkruara!

Pra, ku është gjithë ajo zhurmë që ju i keni plasur kokat e muslimanëve!!

Rezultat i gjithë kësaj është ky, këto janë fjalët e tyre!!

O vëllezërit e mi! Këta njerëz nuk e dëshirojnë islam, vetëm ashtu si e kuptojnë ata, sipas tyre ajo është islam, dhe muslimanë e pushtetarë janë vetëm ata!!

Kurse nëse pushtetin e udhëheq Ebu Bekri, Umeri, të cilët nuk janë nga vëllazëria muslimane! Nuk vlejnë asgjë! Veç së e kanë pohuar këtë gjë në librat e tyre!

Kanë thënë: **“Ata nuk pranojnë në çështjet e udhëheqjes dhe këshillimit dikën që nuk është nga xhemati i tyre, edhe nëse është prej njerëzve më të ditur, më i përkushtuari në adhurim, njeriu që ka kuptim të fesë me së shumti, dhe që është me i denjë ndaj All-llahut”**

Këtu janë katër cilësi! Për All-llahun këto katër cilësi, njëri që i posedon me çfarë urdhëron?!

Përsëri po ju pyes, për All-llahun, vëllezër të nderuar, nëse njeriu është prej njerëzve me të ditur, me i përkushtuari në adhurim, njeriu që ka kuptim të fesë me së shumti, dhe që është me i denjë ndaj All-llahut” më çfarë i urdhëron njerëzit?!

Nuk i urdhëron me asgjë tjetër përveç së me udhëzimin dhe fenë e All-llahut të lartësuar, mirëpo ata thonë: ne nuk e pranojmë atë përderisa ai nuk është nga xhemati ynë!!

Ai i cili e ka themeluar këtë xhemat thotë: **“Nuk pranohet kjo çështje (udhëheqja dhe këshillimi), nga askush përderisa nuk e kupton islamin sipas kuptimit të tyre, në dritën e njëzetë pikave!”** Tekstualisht, kështu e ka pohuar në librin e tij el-Akaid.

Në dritën e njëzetë pikave!! Jo në dritën e Kur ‘an-it dhe Sunetit që ne, përmes tyre e adhurojmë All-llahun, për të cilat Pejgamberi sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem ka thënë: **“I kam len dy gjëra, nëse ju kapeni për to, nuk do të devijoni pas meje, ato janë libri i All-llahut dhe Suneti im”**.

Kjo gjendje është prezentë në mejdan, të nderuar vëllezër dhe bijë, i nxisin njerëzit kundër kujt? Kundër pushtetarëve! Derisa e ndezin fitnen në mesin e tyre!

Pastaj shfaqen vet dhe i mbledhin frutat!!

Pastaj bëhen me të këqij ndaj umetit islam së sa ata pushtetarë që vet këta i kritikonin me parë, që për ta thonë: ata janë të padrejtë!!

Shkaqet e përhapjes se bidatit.

Autor: Shejh Salih elFeuzan, hafidhahUllah

Burimi: (Akidetut-Teuhid f. 223-225)

Shkaqet të cilat kanë ndikuar në përhapjen e bidateve, janë si shkak i dukurive të më poshtme: injoranca ndaj çështjeve të fesë, pasimi i epshit, kapja me fanatizëm pas ideve dhe njerëzve, përngjasimi me jo besimtarë dhe imitimi i tyre. Do t'i cekim këto shkaqe në mënyre me të detajizuar:

E para: Injoranca ndaj çështjeve të fesë:

Sa me shumë që kalon koha dhe njerëzit largohen nga gjurmët e shpalljes, dituria pakësohet dhe përhapet injoranca. Ashtu siç ka treguar Pejgamberi sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem për të në fjalën e tij:

“Kush jeton prej juve do të shoh shumë mospajtime”

(Transmetohet nga. Ebu Davudi dhe Tirmidhiu, kurse Tirmidhiu ka thënë: Hadith Hasen Sahih).

Gjithashtu fjala e tij sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem:

“Me të vërtetë Allahu nuk e heq këtë dituri përnjëherë nga robërit e Tij, mirëpo, e heq diturinë duke ua marr jetën dijetarëve, sa që kur nuk mbet asnjë dijetarë, njerëzit për prijes (dijetarë që i pyesin) të tyre do t'i marrin injorantët, ata do të pyetën dhe do të japin përgjigje (fetwa) pa dituri, devijojnë vet dhe i devijojnë të tjerët”

(Xhamiul-Bejanul-Ilm, Ibën Abdul-Berr 1/180).

Nuk ka mundësi të rezistohet ndaj bidatit, përveç se me dituri dhe me dijetarë, e kur të humbët dituria dhe dijetarët, i jepet mundësia bidateve për tu shfaqur dhe për tu përhapur, kështu që njerëzit e dijës duhet të jenë me vigjilent dhe të punojnë me shumë.

E dyta: Pasimi i epshit:

Kush e refuzon Kur'anin dhe Sunetin, e pason epshin e vet, Allahu i Lartësuar thotë:

ممن ات بيع هواه بغير هدى من الله فان لم يستجيبوا لك فاعلم انما يريدون اهلواءهم ومن اضل

“E nëse ata nuk të përgjigjen ty, atëherë dije se ata ndjekin vetëm dëshiturat e veta, e kush është më i humbur se ai që duke mos pasur fakte prej Allahut, ndjek epshin e vet?...” (Kasas 50).

Po ashtu i Lartësuari thotë:

من اتخذ الله هواه وأضله الله على علم وذم على سماعه وقوله وجعل على بصيرة غشاة فمن أفرأيت يهديه من بعد الله

“A e ke parë ti (Muhamed) atë që duke e ditur, dëshirën e vet e respekton si zot të vetin, atë Allahu e ka humbur, ia ka mbyllur të dëgjuarit dhe zemrën e tij, i ka vënë perde mbi të parit e tij, më thuaj, pos Allahut, kush mund ta udhëzojë atë?...” (Xhathije 23).

Pra, bidatët janë struktura e thurjes së epshit të pasuar **(nga të tjerët)**.

E treta: Kapja me fanatizëm pas ideve dhe njerëzve:

Kapja me fanatizëm pas ideve dhe njerëzve ndërhyr mes njeriut dhe pasimit të argumentit, si dhe njohjes së hakut, i Lartësuar thotë:

وإذا قيل لهم اتبعوا ما أنزل الله قالوا بل نتبع ما آلفينا عليه أباءنا

“E kur u thuhet atyre (idhujtarëve) pranoni atë që Allahu e shpalli! Ata thonë: Jo, ne ndjekim atë rrugë në të cilën i gjetëm prindërit tanë!...” (Bekare 170).

Kështu është halli i shumë prej atyre fanatikëve në ditën e sotme, siç janë disa nga pasuesit e medh'hebeve të safive dhe adhuruesve të varreve, kur ata ftohen për tek Kur'ani dhe Suneti, si dhe për tu larguar nga ajo që ata e ndjekin dhe që bie ndesh me Kur'an dhe Sunet, ata argumentojnë me mendimet **(medh'hebet)** e tyre, me dijetarët e tyre, prindërit dhe etërit e tyre.

E katërta: Përngjasimi me jo besimtarë dhe imitimi i tyre:

Kjo me së shumti i shpie **(njerëzit)** në bidate, siç potencohet në hadithin e Ebi Uakid elLejthij radijAllahu anhu, ku thotë:

“Dolëm me të Dërguarin e Allahut sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem në Hunejn, e ne ishim rishtazi të larguar nga kufri **(mosbesimi)**, kurse idhujtarët kishin një pemë që qëndronin pranë saj dhe i varnin armët e tyre në të, të cilën e quanin Dhetu Enuat.

Kaluam pranë një pemë dhe i thamë:

O i Dërguar i Allahut! Na e bëj edhe neve një Dhatu Enuat ashtu siç e kanë ata **(idhujtarët)** Dhatu Enuat? I Dërguari i Allahut sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem na tha: Allahu Ekber, këto janë tradita **(zakone)**! Thatë –pasha Atë në dorën e të Cilit është shpirti im- ashtu siç i kanë thënë Beni Is’railët Musait:

قَالُوا يَا مُوسَى اجْعَلْ لَنَا إِلَهًا كَمَا لَهُمْ آلِهَةٌ قَالَ إِنَّكُمْ قَوْمٌ تَجْهَلُونَ

“...dhe thanë: O Musa, na e bën edhe ne një zot si zotët që i kanë ata (idhujtarët)! Ai (Musai) tha: Ju jeni popull që nuk dini” (‘Araf 138),

“Do t’i pasoni traditat e popujve që ishin para juve” (Transmetohet nga Tirmidhiu dhe e ka bërë sahih).

Ky hadith nënkupton së: Përngjasimi me jobesimtarë është ajo që i ka nxitur Beni Is’railët për të kërkuar një gjë të tillë kaq të shëmtuar. Që do të thotë: T’ia sajoi atyre një të adhuruar **(statujë)** dhe pastaj ta adhurojnë ata.

Po ashtu, kjo i ka shtyrë sahabët e Muhamedit sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem që të kërkojnë prej tij që t’iu bëj një pemë, e më pas të kërkojnë begati prej saj pos Allahut të Lartësuar.

Ashtu siç po ndodh edhe në ditën e sotme, sepse, shumica e myslimanëve i imitojnë jo besimtarët në veprat e shpikura **(bidate)** dhe shirkijate, siç janë festimet e ditëlindjeve, festimi i ditëve dhe javëve me veprime të veçuara, festimet për ndodhi fetare dhe përkujtime, ngritja e statujave, mbajtja e përkujtimeve, tubimi në raste pikëllimi, bidatet e xhenazes, ndërtimet mbi varreza, e të tjera.

Selefite janë të pastër nga veprimet terroriste.

Shkruar nga: shejh Ahmed ibën Jahja en-Nexhmij, RahimehUllah me:
22/07/1426h.

Burimi: <http://www.sahab.net/home/?p=1571>

Lavdi i takon Allahut, ndërsa paqja dhe bekimi i Tij qoftë mbi të Dërguarin e Allahut, familjen dhe shokët e tij, e më pas:

Me të vërtetë Allahu e dërgoi Pejgamberin me udhëzim dhe me fe të vërtetë, që të ngadhënjën mbi çdo fe edhe pse idhujtarët këtë e urrejnë. Jetëshkrimi i të

Dërguarit të Allahut sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem është vet reflektimi praktik i sheriatit të Allahut të Lartësuar të cilin Allahu ia ka shpallur atij sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem, si dhe për të cilin Allahu ka urdhëruar të pasohet në fjalën e Tij:

وَإِنَّ شَيْنًا لِّلَّهِ مِنْ عَنكَ يُغْنُوا لَن إِنَّهُمْ -18- يَعْلَمُونَ لَا الَّذِينَ أَهْوَاءُ تَتَّبِعْ وَلَا فَاتَّبِعْهَا الْأَمْرُ مِّنْ شَرِيعَةٍ عَلَىٰ جَعَلْنَاكَ ثُمَّ ((
(الْمُتَّقِينَ وَلِيٍّ وَاللَّهُ بِعُضٍّ أَوْلِيَاءَ بَعْضُهُمُ الظَّالِمِينَ))

“Pastaj, Ne të vumë ty në një rrugë të drejtë të fesë, pra ti ndiqe atë e mos i ndiq dëshirat e atyre që nuk dinë. Ata nuk mund të mbrojnë ty për asgjë tek Allahu. Zullumqarët janë miq të njëri-tjetrit, kurse Allahu është mbrojtës i besimtarëve të devotshëm” (Xhathije 18-19).

Pejgamberi sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem veç së e ka ndaluar thyerjen e besës dhe tradhtinë, si dhe ka urdhëruar me besnikëri, ndershmëri dhe besueshmëri.

Pejgamberi sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem

“Kur e caktonte një emir (prijës) në ushtri apo në tog, e këshillonte atë posaçërisht me frikë ndaj Allahut, pastaj i thoshte: Luftoni me emrin e Allahut në rrugën e Tij, luftojeni atë që e mohoi Allahun; luftoni dhe mos e teproni, mos e thyeni besën, mos masakroni dhe mos mbytni fëmijë” (Transmeton. Muslimi).

Kurse, në një transmetim tek Tabaranij në Mu’xhem esSagir me nr. Të hadithit 340: **“Dhe mos u frikësoni, mos mbytni fëmijë, e as gra dhe as të moshuar.”**

E ka ndaluar Pejgamberi sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem thyerjen e besës, si dhe e ka ndaluar **(bërë haram)** tradhtinë të cilën po e manifestojnë terroristët; gjithashtu e ka ndaluar mbytjen e grave dhe fëmijëve, e edhe të moshuarve, të cilët nuk janë të aftë për të luftuar dhe nuk luftojnë, e ka ndaluar mbytjen e këtyre, e po ashtu e ka ndaluar shkatërrimin **(në tokë)**,

Allahu i Lartësuar thotë:

(((الْمُحْسِنِينَ مِّنْ قَرِيبٍ اللَّهُ رَحِمَتْ إِنَّ وَطْئاً خَوْفًا وَادْعُوهُ إِصْلَاحِهَا بَعْدَ الْأَرْضِ فِي تَفْسِدُوا وَلَا))

“Mos bëni çrregullime në tokë pas rregullimit të saj dhe lutuni Atij duke pasur frikë dhe duke shpresuar. S’ka dyshim se mëshira e Allahut është pranë atyre të mirëve” (‘Araf 56).

Pra, Allahu na kumtuar së nuk i do ata që bëjnë shkatërrim, si dhe ka kumtuar së Allahu nuk iu jep sukses intrigave të tradhtarëve.

Po në këtë rrugë, vazhduan sahabët e tij sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem. Kur shkonin tek ndonjë popull prej jo besimtarëve, i ftonin në Islam fillimisht, e nëse ata refuzonin dhe ishin nga ithtarët e librit, ua kërkonin xhizjen, e nëse edhe këtë e refuzonin, atëherë ua shpallnin luftën dhe iu tregon se do t’i luftojnë. Pra i luftonin pasi që iu tregonin atyre për luftë.

Kurse, në qoftë së ishin jo besimtarë nga idhujtarët, atyre iu ofronin të zgjidhnin mes Islamit dhe luftës, si dhe i luftonin pasi që i informonin së do t’i luftojnë.

Kurse, ajo që e veprojnë terroristët në këtë kohë, duke vendosur lënde shpërthyesë në trup, apo duke ngasë makina me lënde shpërthyesë dhe pastaj kur shohin ndonjë turmë njerëzish, e hedh vetën në ajr apo makinën e tij dhe vetveten, kjo çështje buron nga tradhtia, kurse Islami është shumë larg kësaj dhe assesi, kurrë nuk e miraton këtë.

Ato veprime vetëvrasëse që po ndodhin në Britani dhe në vende të tjera, janë duke i projektuar tekfircat havarixh.

Të cilët i ka qortuar i Dërguari i Allahut sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem në fjalën e tij: **“Do të shfaqet në kohën e fundit një popull i ri në moshë, mendjelehtë, flasin me fjalën me të mirë të Allahut, dalin nga feja ashtu siç del shtiza nga gjahu, nuk e kalon imani fytin e tyre, kudo t’i takoni vritini, sepse në vrasjen e tyre ka shpërblim për atë që i ka vrrarë ditën e Kiametit”.**

Është vërtetuar nga Pejgamberi sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem që ka thënë:

“Të vrrarët më të këqij nën kupën e qiellit”, po ashtu ka thënë: **“Vrasësi më i mirë është ai që i vret”,** po ashtu ka thënë: **“Lum ai që i vret ata apo që e vrasin ata”,** po ashtu ka thënë: **“Kudo që t’i gjeni, vritni ata, sepse në vrasjen e tyre ka shpërblim tek Allahu”,** po ashtu ka thënë për ta: **“Qentë e zjarrit (xhehenemit)”**, po ashtu ka thënë: **“Po t’i arrija do t’i luftoja sikur popullin e Adit”** e në një transmetim: **“Sikur popullin e Themudit”,** po ashtu ka thënë: **“Do të dalin marikitë (emër i havarixhëve), dalin nga feja ashtu siç del shtiza nga gjahu dhe pastaj nuk kthehen më në të (në fe) deri sa të kthehet shtiza në harkun e vet”** kurse kuptimi i fjalës ‘mereka’ do të thotë: dalin nga ana tjetër. Pra, havarixhët dalin nga feja dhe asgjë prej saj (**fesë**) nuk mbetet (**ngjitët për ta**) në ta.

Duke u bazuar në këtë, Islami është i pastër nga këto veprime të pa matura marrëzie, për këtë duhet të ndëshkohet ai që vepron kështu dhe duhet të urrehen veprimet e tyre.

Ata, të cilët i akuzojnë selefite të cilët e pasojnë librin e Allahut dhe sunetin e të Dërguarit të Tij sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem dhe që ecin në rrugën e sahabëve, që i akuzojnë për eksplozime në Britani apo diku tjetër, me eksplozime që

përfshijnë vrasjen e njerëzve, humbjen e pasurisë, derdhjen e gjakut, frikësimin e njerëzve si dhe kryengritjen kundër pushtetit, ata që i akuzojnë selefite me këtë, po ata janë kryerësit e këtyre gjërave të urryera.

Dëshirojnë t'ia adresojnë dikujt tjetër, kurse ata janë pjesëtarët e Alkaidës, të cilët e pasojnë Usam ibën Laden, elMisarin, Sad elFekihin dhe të tjerët sikur këta.

Sepse, këta u edukuan në frymën e librave të tekfirijinve, siç është Sejid Kutbi dhe ata që janë me të në këtë rrugë të gabuar, të cilët i konsiderojnë pa besimtarë umetin e Muhamedit sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem pa të drejtë, përkundrazi i konsiderojnë pa besimtarë për mëkate, e nga mëkatet nuk shpëton askush.

E në fakt, nuk lejohet ta bëjmë pa besimtarë (**tekfir**) askënd nga myslimanët, përveç, kë e ka bërë pa besimtarë Allahut i Lartësuar, siç janë idhujtarët që kanë shirk të madh.

Allahu i Plotfuqishëm thotë:

((الْخَاسِرِينَ مِنْ وَلَتَكُونَنَّ عَمَلُكَ لِيَخْبَطَنَّ أَشْرَكَتَ لَنْ قَبْلِكَ مِنَ الَّذِينَ وَإِلَى إِلَيْكَ أُوْحِي وَلَقَدْ))

“Veç së të është shpallur ty prej Allahut e edhe atyre para teje: “Nëse i bën shok Allahut, veprat tuaja janë të asgjësuar dhe ti do të jesh prej të humburve” (Zumer 56).

Po ashtu i Lartësuari thotë:

((الْكَافِرُونَ يَفْلَحُ لَا إِنَّهُ رَبِّهِ عِنْدَ حِسَابِهِ فَإِنَّمَا بِهِ لَهُ بُرْهَانٌ لَا آخَرَ إِلَهًا اللَّهُ مَعَ يَدْعُ وَمَنْ))

“E kush adhuron me Allahun ndonjë të adhuruar tjetër, për të cilin nuk ka kurrfarë fakti, përgjegjësia e tij është para Zotit të vet, e mohuesit nuk do të shpëtojnë” (Mu'minunë 117).

Po ashtu i Lartësuari thotë:

((الْمُعَذِّبِينَ مِنْ فَتَكُونَ آخَرَ إِلَهًا اللَّهُ مَعَ تَدْعُ فَلَا))

“Pra, përpos Allahut, mos adhuro tjetër të adhuruar e të bëhesh prej të dënuarve” (Shuara 213).

Po ashtu i Lartësuari duke pohuar fjalën e Isai, të birit të Merjemes thotë:

((مِنَ الظَّالِمِينَ وَمَا النَّارُ وَمَاوَاهُ الْجَنَّةُ عَلَيْهِ اللَّهُ حَرَّمَ فَقَدْ بِاللَّهِ يَشْرِكُ مَنْ إِنَّهُ وَرَبُّكُمْ رَبِّي اللَّهُ اَعْبُدُوا إِسْرَائِيلَ بَنِي يَآ))
(أَنْصَارِ)

“...O Beni Israil, adhuroni Allahun, Zotin tim dhe Zotin tuaj, sepse ai që i përshkruan Zotit shok, Allahu ia ka ndaluar atij xhenetin dhe vend i tij është zjarri. Për mizorët nuk ka ndihmës” (Maide 72).

Ky është realiteti që nuk i lejohet askujt të largohet prej tij, e kush pretendon të kundërtën e kësaj, siç janë tekfirijnët, të cilët i konsiderojnë pa besimtarë ata që kanë teuhid, falën dhe agjërojnë, ai është në të kotën, thirrës për tek e kota. Ky është realitet që nuk lejohet të dyshohet në të dhe as nuk lejohet të anohet prej tij, vërtetë prej Allahut është suksesi.

Paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të Dërguarin tonë, Muhamedin, familjen dhe shokët e tij.

Përvoja ime me xhematin Ih’vanul-Muslimine.

Autor: Shejh Muhamed Eman elXhamij, RahimehUllah

Burimi: <http://www.sahab.net/forums/index.php?s ... pic=149638>

Pyetja: “Gjatë fjalimit tuaj pohuat së ju keni përvojë me xhematin Ih’vanul-Musliminë, dëshirojmë nga ju, një pasqyrim nga kjo dhe të përfitojmë nga kjo përvojë?”

Përgjigja: Lavdi i takon Allahut, kurse paqja dhe bekimi i Tij qofshin mbi të Dërguarin e Allahut, familjen dhe shokët e tij, e më pas:

Të vazhdojmë më përgjigje ndaj disa pyetjeve – kuptohet ato që mundemi-kurse, kjo është një pyetje me rëndësi.

Sa i përket përvojës sime me xhematin Ih’vanul-Musliminë, në disa nga përvojat e mia jam i veçuar prej juve, e në disa jeni pjesëmarrës edhe ju më mua, lavdi i qoftë Allahu dhe shumë prej tyre edhe ju i keni përjetuar.

E para: Në fillim të rinisë sime disa nga thirrësit e xhematit bën përpjekje –të cilët sipas asaj që ata i konsiderojnë si njerëz që i përvetësojnë **(thirrin)** të tjerët- u përpjekën të me përvetësonin edhe mua në shumë mënyra.

Gjatë një përpjekje, njëherë me morën me veti tek njëri nga prijësit e tyre të mëdhenj në një qytet prej qyteteve.

Udhëtuam një ditë të plotë dhe unë isha i dyshimtë...mirëpo, kur hymë tek ky njeri i madh **(më pozitiv)**, i cili i udhëhiqte këta **(xhematin Ih'vanul-Musliminë)**, kur papritmas e vëreja se ky njeri posedon një mexhlis të madh dhe aty u shpërndan shpuzoret për shkundjen e cigareve; kurse unë thash në vete kjo është e para, pra, kjo është nga pikat.

Njëherë qëndruam në një ndejë dhe nuk ishte askush përveç meje dhe ai **(personi)** që më dërgoi tek ai shejh. Më pas hyri një i ri, kishte mjekrën e rruar, thua jse tani ka dalë nga salloni i qethjes, u vetëpërmabajta nga të folurit, e llogarita si të huaj prej neve **(që s'ka lidhje me ne)**.

Me thanë: Ky është nga të veçuarit e Ih'vanul-Musliminëve –u shkatërrua Hajberi **(fjalë e urtë)** - thash kjo është e dyta!

Në qoftë se ky është nga të veçuarit e xhematit atëherë për kë është thirrja? Në qoftë se e bëjmë hallall duhanin, ua shpërndajmë shpuzoret duhanxhinjve dhe atyre që i kanë rruar mjekrat, i cili ka nevojë për thirrje dhe udhëzim që është nga të veçuarit e veçantë të tyre, atëherë për kë është thirrja?

Përfundoj mexhlisi dhe u kthyem unë dhe shoqëruesi im dhe fola me të gjatë rrugës, i thash: Për çfarë thirrni? Me tha: O filan, ti nuk e ke kuptuar metodologjinë e Ih-vanve?!

Në metodologjinë e Ih'vanve tani nuk flitet për punë të neveritshme, e as për mëkate, e as për pije dehëse, e as për rreshta, e as për ndonjë qëllim, mirëpo, në nxitojmë për ta ngritur hilafetin e përgjithshëm, pra duam të ndërtojmë shtetin islamik mbi çdo tokë dhe ndër çdo qiell, e gjithë toka të jetë e tyre **(e myslimanëve)**.

Pasi të ndërtojmë shtetin e përgjithshëm –hilafetin e përgjithshëm- ata qanin për hilafetin e osmanlive dhe nuk e dinin fare se çfarë pragjeve kishte pasur në të, Allahu qoftë në ndihmë!

Pasi të ndërtojmë hilafetin e përgjithshëm, pas kësaj fillojmë me përmirësimet në Islam: **(iu themi)** alkooli është haram, punët e neveritshme janë haram, heqja e mjekrës është haram, pra, pas kësaj. Kurse tani, jo! Iu thash: kështu! Me thanë: kështu! Iu thash: këtu është dallimi mes meje dhe juve, që tash e tutje mos u mundo kotë, bërë përpjekje që të më besh njërin prej juve, porse tani jo!

Metodologjia e Islamit nuk është kështu, metodologjia e Islamit fillon me përmirësimin në çdo gjë. Çështjen e parë që fillon për ta përmirësuar metodologjia e Islamit është përmirësimi i akidës, nuk bën ta injorojmë gjendjen aktuale, bindjet e shumë popujve myslimanë tanimë janë të prishura, është përhapur idhujtaria dhe shirku ndaj Allahut me gjitha llojet e tij në mesin e tyre.

Në qoftë së i lemë kështu, mos ta refuzojmë shirkun e as bidatet, të nxitojmë për ngritjen e shtetit dhe ta bëjmë Islamin vetëm simbol, simbol i thatë që nuk veprohet me të, t'i mashtrojmë njerëzit me të. Do t'i mashtrojmë njerëzit nëse e ngritim lartë një pllakat ku shkruan ky është Islami i madh **(nëse nuk veprojmë me të)**, e në këtë nuk shpresohet diçka e hajrit.

Njëri nga kokat e tyre veç së e ka pohuar së ata nxitojnë për të arritur në kupën e parlamentit, që do të thotë: Islami është një mjet për të hipur mbi shpinën e tij deri sa të arrijnë në kupën e parlamentit, pastaj e lëshojnë dhe e largojnë **(Islamin)**! Ky është Islami tek ta, kjo është tallje me Islamin. E marrin Islamin mënyrë dhe mjet për të arritur në parlament! Kjo është një pjesë nga përvoja ime, kurse në pjesën tjetër jeni pjesëmarrës edhe ju.

E dyta: Kurse, rastet kur edhe ju jeni pjesëmarrës me mua në këtë përvojë janë:

Kur janë shfaqur rrafiditë **(shiat)** dhe kur ata e ndërtuan shtetin e tyre, çfarë bënë kokat **(prijësit)** e Ih'vanve?

Udhëtuan nga çdo vend –me përjashtim ky vend **(Arabia Saudite)** - shkuan dhe i uruan, e begatuan dhe e puthen ballin dhe fytyrën e rrafidizmit. E më pas, e bën si porosi të tyre: Bëhuni Humejnijnë **(si Homeini)**, çdo njeri prej juve le të jetë Humejnij në vendin e vet!

Pra, Ih'vanet ishin me humejnijnët **(me Homeinin)**, kur rrafiditë u përpjekën për ta prishur Xhaminë e shenjtë, kur i sulmuan banorët e dy vendeve të shenjta, kur iu bën keq haxhilerëve që shkonin në shtëpinë e Allahut, Ih'vanet ishin miqtë dhe aleatët e tyre. Këtë mund t'ju vërtetoj juve me foto të cilat i kanë bërë ata me këtë njeri **(me Homeinin)**.

Kur ua falen xhenazen të vdekurve të tyre, i quajtën dëshmor **(shuheda)**, të vrarët e rrafidive i quajtën dëshmor dhe ua falën namazin e xhenazes dhe jetuan **(qëndruan)** me këtë njeri **(Homeinin)** një kohë të gjatë!

Ndryshoi politika ashtu siç është traditë e saj, u shfaq njeriun i Bagdadit **(Sadam Husejni)** dhe e shpallen pa besimtarë edhe njeriun e Teh'ranit **(Homeinin)**, dikur u drejtuan kah Bagdadi dhe qëndruan në pragun e Sadamit dhe e emëruan me llagapin Salahud-din Ej-jubij, muxhahidi i madh, përmirësuesi i madh!

Po ashtu shkatërrimin e tij ndaj Kuvajtit, shkatërrimin e shteteve të gjirit dhe Saudisë, gjithë këtë e quajtën përmirësim dhe çlirim të Kudsit, kaloi Kudsi në Kuvajt!

Kështu veprouan Ih'vanët, e akoma veprojnë kështu, sa që deri vonë njëri nga kokat e tyre shkonte tek Sadami, kohë pas kohe, sa që disa nga gazetatat kohën

e fundit janë tallur me të: **“Kur të shkoni Turabi tek Sadami, a i jep fetwa apo merr fetwa prej tij, cili prej tyre është mufti?”**

Sepse Turabi nxiton pas asaj që nxiton Sadami, sipas rezultatit që ka dal në fund!

A nuk e kuptoni fik-hul-vakian? A nuk është fik-hul-vaki veç se kjo? Në qoftë së nuk e kupton këtë, atëherë jeni njerëzit me të paditur ndaj fik-hul-vakias! Kjo është fik-hul-vakia, aktualiteti i njerëzve, kjo është kështu që nga dita që janë shfaqur e deri në këtë kohë.

Ata bashkëpunojnë me kriminel, me njerëz të prishur, edhe pse të rinjve ua zbukurojnë me të mirën –kryesisht të rinjtë tanë janë të mirë-.

Kur u shfaq lëvizja e Ih'vanve në Algjeri, në Tunisi, në cilin do vend, ata e quajtën këtë lëvizje: Lëvizje Islame, e në fakt është shkatërruese xhahilije **(injorance)**. E cila thërret për parlament, kurse parlamenti është kufër, asnjëherë nuk e ka ftuar një qytetar për t'u gjykuar tek Islami, por e fton për parlamenti.

Nuk ka dallim mes qytetari –ai i cili tek njerëzit njihet si selefij dhe thirrës- s'ka dallim mes tij dhe mes atyre që janë në ulëse **(në parlament)**. Në se ata që janë në ulëse gjykojnë me ligjin francez, në qoftë së e votojnë qytetaret dhe arrin në pushtet dhe nëse dëshiron e heq ligjin francez, e pastaj e vendos ai dhe shokët e tij ligjin algjerian dhe më pas gjykojnë me të në parlamentin e tyre, këtu i pyes kërkuesit e dijës: A ka dallim mes kufrit të importuar dhe atij vendorë? Nuk ka dallim mes tyre, porse ligji i tyre është kufër vendorë, kurse ligji francez kufër i importuar. Në Islam s'ka dallim mes kufrit të importuar dhe atij vendorë.

Përkundrazi legjislacionet e shujuhve të shkretëtirave nëse i vëren në çështjet e hallallit dhe haramit, e kupton së janë ligj, tagut dhe gjykim me diçka tjetër pos asaj që e ka zbritur Allahu.

Mësojeni se, kuptimi i gjykimit me diçka tjetër pos Allahut nuk është vetëm importimi i ligjeve nga jashtë! Legjislacionet që janë të njohura tek banoret e shkretëtirës, ligjet që i vendosin të rinjtë nga mesi jonë, që flasin gjuhën tonë, që atribuohen tek feja jonë, i vendosin ligjet nga vetja e tyre, gjitha këto s'kanë dallim mes tyre dhe ligjit francez dhe anglez, gjitha janë njëjtë, gjitha janë gjykim me diçka tjetër pos asaj që e ka zbritur Allahut dhe është kufër ndaj Allahut.

Këto janë disa nga përvojat e mia me ta. Ata nuk e kanë ndryshuar metodologjinë e tyre, akoma bashkëpunojnë me armiq të thirrjes islame, mirëpo veprimi në emër të Islamit është politikë, Islam politik.

Nga politika e tyre është që t'i lënë injorantë masën, masa tek ta duhet të mbet e pa ditur, mos të mëson. Mos të mësojnë dhe t'i bashkojnë sikur rrafiditë.

A e dini së rrafiditë janë njerëzit me të paditur, me të paditur së injorantët tanë, sepse ata kanë bindjen së duhet bërë nënshtrim **(ta'atu)** ndaj dijetarëve, kurse masa jonë nuk e kanë bindjen së duhet nënshtruar ndaj dijetarëve. Tek ne, nuk ka nënshtrim ndaj dijetarëve, përveç tek rrafiditë, është kjo akide e cila është transferuar tek Ih'vanet, ata e shohin së masa duhet t'i nënshtrohet atyre dhe duhet të mbetët në injorancë deri sa t'iu nënshtrohet atyre me nënshtrim të verbër.

Ky është realiteti i këtij xhemati shkurtimisht.

Thirrja e Muhamed ibën Abdul-Vehabit.

Autor: Shejh Albani, RahimehUllah!

Burimi: (Silsiletul-Huda ueN-nur Nr. i kasetës 291)

Pyetja: “Një njeri thotë: Po dëgjojmë shumë për (të ashtuquajturin) Vehabizmin dhe po dëgjojmë së ata e urrejnë dërgimin e salaveteve mbi Pejgamberin sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem, e as nuk e vizitojnë varrin e tij sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem dhe disa shujh thonë së Pejgamberi sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem ka paralajmëruar për ta: “Nexhdi është briri i shejtanit”, cila është përgjigja juaj për këto fjalë?”

Përgjigja: “Në fakt kjo pyetje, me keqardhje e them, ka lënë gjurmë të mëdha tek shumë myslimanë. Kjo ka ardh si shkak i propagandës së politikës në të kaluarën, mirëpo kësaj politikë i ka kaluar koha dhe i ka përfunduar, sepse kjo ishte pjesë e politikës së shtetit turk –nuk po e zgjas me shumë, porse ky është vetëm një pasqyrim i shkurtër- e shfaqën **(këtë akuzë)** ditën kur u shfaq ky njeri i ditur dhe përmirësues, i quajtur Muhamed ibën Abdul-Vehab në disa vende të Nexhdit duke i thirrur njerëzit në singeritet për të cilin veç së folëm më parë, në adhurim të Allahut të Vetëm dhe mos t'i behët shirk asgjë Atij. Gjurmët e të cilit **(shirkut)** fatkeqësisht akoma janë prezent në disa vende islame, gjë që në këtë vend **(Nexhd dhe rrethina e tij)**, nga ka dalë shejhu përmirësues Muhamed ibën Abdul-Vehab , Allahu e mëshiroftë, nuk është më prezent shirku.

Në këtë zonë deri me tani, lavdi i qoftë Allahut, nuk ka ndonjë lloj shirku siç e shohim në shumë vendet islame: Egjipt, Jordani dhe Siri, apo në vendet e huaja, apo në Iran. Lajmi i Homeinit dhe vdekjes së tij, konsiderimi i varrit të tij si Qabe ku iranienët e vizitojnë, ky lajm për juve nuk është i hershem.

Ky njeri (**Muhamed ibën Abdul-Vehabi**) kur u shfaq dhe thirri për adhurimi ndaj Allahut të Plotfuqishëm e të Vetëm u akordua me një urtësi që e dëshiroi Allahu i Plotfuqishëm. Kjo urtësi ishte prania e një princ prej princave të Nexhdit, e ky ishte Su'udi, gjyshi i mbretit aktual (**të Arabisë Saudite**).

Bashkëpunojë shejhu me princin dhe bashkëpunoj dituria me shpatën. Filluan ta përhapin thirrjen e Teuhidit në vendet e Nexhdit duke i thirrur njerëzit nganjëherë –dhe kjo është kështu në parim- nganjëherë me fjalë, e nganjëherë me shpatë. Kush i përgjigjet fjalës, kjo ishte ajo që kërkohej, se përndryshe nuk do të realizohej thirrja veç së me forcë.

U përhap kjo thirrje sa që arriti edhe në vende të tjera, duke pas parasysh së vendet e Nexhdit dhe vendet tjera islame për rreth saj, siç është: Iraku, Jordania e shumë të tjera ishin nën pushtetin e turqve, të cilët e mbanin pushtetin me trashëgimi (**njëri pas tjetrit**).

Kur u manifestua emri i këtij njeriut me dituri dhe këtij princi me administrim, u përhap e u përhap (**thirrja e tij**), turqit u frikësuan së në botën islame do të shfaqet një shtet që e sfidon shtetin e turqve! Insistuan ta zhdukën edhe pse ishte mu në vatrën e vet (**si shtet fillestar**), me thashetheme të kota ndaj tyre, me gënjeshtër dhe shpifje ashtu siç u ceken në pyetje apo shumë gjëra të tjera, kurse ato që i dëgjojmë ne, janë shumë e me shumë. Unë thash me herët së shkakut kryesorë është faktori politik, pra ky është shkakut.

Mirëpo, kjo politikë ka përfunduar dhe ne nuk jemi duke bërë hulumtim historik.

Kurse, shkakut tjetër është injoranca e njerëzve ndaj kësaj thirrjeje. Kjo injorancë ma kujton mua një tregim që e kam lexuar në disa nga revistat. Dy burra polemizonin rrugës për thirrjen e Muhamed ibën Abdul-Vehabit të cilën (**thirrje**) e quajnë vehabizëm.

Sikur njerëzit të mendonin për atë që e flasin, veç kjo fjalë që e thonë do t'ju mjaftonte si përkujtim së ata janë duke gabuar kur e pohojnë këtë. Sepse, shprehja vehabizem nëse duam të shikojmë për prejardhjen e saj dhe kujt i atribuohet, e shohim së vehabizmi i atribuohet emrit elVehab, e kush është elVehab? Ai është Allahu i Lartësuar!

Pra, shprehja Vehabizem është nder dhe nuk është nënvlerësim, mirëpo është një shembull që e thonë tek ne, në Siri: **“Në veshët e tyre është një gjë e**

frikshme sikur bubullima shumë e frikshme.” (sipas tyre) Vehabitë nuk e besojnë të Dërguarin, nuk besojnë në diçka tjetër pos Allahut!

Ky hulumtim ma kujtoj rastin e këtyre dy burrave që polemizonin, e ky injoranti pretendonte që ata **(Vehabitë)** nuk besojnë veç se në Allahun, kurse Muhamedin si të dërguar të Allahut nuk e besojnë dhe nuk thonë veç se La ilahe Il-lAllah.

Tek ne, në Sham duke u bazuar në këtë tregim të Shamit, duhet t’ju them juve me dialektin e Shamit, kur pranë juve kalon konsulli apo ambasadori saudian në këtë vend **(Siri)**, flamuri i vendit të tij valon në makinën e tij dhe aty shkruan qartë La ilahe il-lAllah Muhamedun resul-Ullah.

O njerëz kini frikën Allahut! Si thoni këta njerëz nuk besojnë në diçka tjetër pos Allahut, kurse flamuri i tyre është i vetmi flamur në dynja, në të cilin shkruan deklarata e Teuhidit, për të cilin Pejgamberi sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem ka thënë: **“Jam urdhëruar t’i luftojë njerëzit deri sa të dëshmojnë fjalën La ilahe Il-lAllah Muhamedun resul-Ullah, e kur ta thonë këtë, është i garantuar gjaku i tyre dhe pasuria e tyre, përveç së me të drejtë, kurse llogaria i takon Allahut”**.

Si thoni për këta njerëz dhe shpifni ndaj tyre, kurse ky është flamuri i tyre i ngritur që simbolizon atë iman që është në gjokset e tyre!

Kjo është gjëja, gjëja më e madhe dhe me e rëndësishmja. Për këtë flamur mund të thuhet që është i falsifikuar dhe është thjesht një pretendim mashtrues etj, mirëpo si është gjendja e tyre, deri me tani njerëzit e bëjnë haxhin të sigurt dhe të qetë, këtë **(haxhilerët)** nuk e përjetuan në kohën e turqve të cilët i kanë përhap këto thashetheme ndaj tyre dhe këto shpifje të rrejshme.

Ju e dini që shumë vite prindërit tanë, e aq me keq gjyshërit tanë, ishte e domosdoshme për çdo ekuipazh të haxhilerëve nga cilido vend të shoqërohej nga njerëzit e armatosur, të gatshëm për t’i mbrojtur njerëzit e atij ekuipazhi nga kusarët.

SubhanAllah! Kjo gjë ka kaluar dhe ka përfunduar, me çfarë politike? Me politiken të cilën ata e quajnë Vehabije deri në këtë çast.

Në qoftë së kushtimisht themi së ky flamur që valon dhe e manifeston imanin e mirëfilltë dhe Teuhidin e pastër, e që krahas tij është imani në Muhamedin si pejgamber, është i falsifikuar dhe i shpifur, a nuk po shihni se ata qëndrojnë në xhamia duke e adhuruar Allahun. Myezini e thirr ezanin ashtu siç thirret në çdo vend. Me përjashtim disa shtesa **(që s’kanë bazë)** para dhe pas ezanit që thuhet në vende tjera, aty nuk thuhet, sepse ata e pasojnë sunetin.

Nuk e mohon askush fjalën e Pejgamberit sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem, ai është pejgamberi i islamit dhe i gjithë krijesave në çdo kohë dhe çdo vend, mirëpo **(veprimi i tyre)** është si shkak i pasimit të selefit, siç thuhet: Çdo e mirë është në pasimin e selefit, e çdo e keqe është në shpikjet e halefit!

Deri me tani, njerëzit shkojnë në haxh dhe e dëgjojnë këtë ezan me dëshminë se vetëm Allahu duhet të adhurohet dhe me dëshminë së Muhamedi është pejgamber, pastaj falën sikur na, e përmendin Pejgamberin salAllahu alejhi ue selem dhe sa herë që e përmendin, dërgojnë salavate mbi të ndoshta me shumë së sa këta njerëz që shpifin ndaj tyre, që thonë Vehabitë nuk e donë Pejgamberin sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem dhe nuk dërgojnë salavat mbi të!

O njerëz kini frikën Allahut! Kjo është shpifje që realiteti i tyre **(që ata i quajnë Vehabij)** e hedh poshtë.

Sa që nuk mund të thuhet së këta njerëz bëjnë lajka, porse kjo është si shkak i asaj që buron nga zemra e tyre, imani në La ilahe il-lAllah Muhamedun resul-Ullah, si dhe ecja në rrugën e Pejgamberit sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem, duke mos shtuar asgjë dhe nuk po them duke pakësuar, sepse pakësimi është gjë e natyrshme tek njeriu.

Nuk mundet njeriu **(që ta ndaloj pakësimin)** – mirëpo në aspektin e akidës as nuk shton e as nuk pakëson, kurse në aspektin e adhurimit nuk shton, mirëpo pakësimi ndodh, si për shembull, disa nuk falën natën kur njerëzit flenë, mirëpo ky pakësim nuk ndikon në akiden e tij, e as në Islamin e tij, pra kjo fjalë **(shpifje)** deri me sot është shpifje ndaj këtyre, kurse ata janë të pastër nga kjo ashtu siç thuhet: Është i pastër ujku nga gjaku i birit të Jakubit!”

Rreziku i përhapjes përgojimit (gibetit) në mesin e njerëzve.

Autor: Shejh Muhamed ibën Salih elUthejmin, RahimehUllah!

Burimi: (Likaul-Babul-Meftuh 7/66)

Ne i shohim disa njerëz tani që përhapin fjalë ndaj disa njerëzve të caktuar, përhapin fjalë dhe vepra ndaj dijetarëve çfarë ata nuk i kanë thënë dhe nuk i kanë vepruar. E atë me keq përhapin fjalë dhe vepra për pushtetarët dhe udhëheqësit çfarë ata nuk i kanë thënë dhe nuk i kanë vepruar.

Përgojimi ndaj dijetarëve dhe pushtetarëve, siç është mbreti apo ministri e të tjerë, është më i rëndë se sa përgojimi ndaj njerëzve në përgjithësi. Sepse përgojimi i parisë e shkakton urrejtjen ndaj prijësit, e kur njeriu e urren prijësin e vet nuk e dëgjon fjalën e tij, kështu që çdo punë të mirë që e vepron prijësi përveç së mungon në sytë e këtij njeriu, e çdo punë të keqe që e vepron prijësi i bie në sy dhe në zemër, përse? Sepse, nuk e do prijësin dhe e urren si shkak i asaj që është përhap ndaj tij, siç ka thënë një poet i mençur:

“Syri i kënaqësisë (epshit) ndaj çdo të mete është i kënaqur – Ashtu siç syri i hidhërimit i sheh gjërat e barabarta.”

Njeriu i hidhëruar mos mendo se e përhap të mirën e atij që është i hidhëruar në të, mirëpo ky njeri i zëmëruar urryes i përhap gjitha të këqijat dhe hesht ndaj të mirave sikur mos me ndodh fare.

Pra, përgojimi i prijësit e shkakton urrejtjen e tij dhe armiqësinë, si dhe mos nënshtrimin ndaj urdhrit të tij, të mirat i bën të këqija, e kjo është e rrezikshme për gjithë shoqërinë. Sepse kur gjërat kalojnë në kaos që nuk kanë frerë prishet rëndi, përçahet Umeti.

Po sikur për shembull t’i përhapim të këqijat e prijësit, a e përmirëson kjo gjendjen sadopak? Sikur ta përmirësonte gjendjen do të ishte mirë, mirëpo nuk përmirësohet, përkundrazi gjendja eskalon me shumë.

Kështu që prijësi e vëren këtë dhe bie në atë që nuk është e drejtë e tij, siç është akuzimi i atyre që s’kanë faj me ndonjë çështje çfarë ata janë të pastër prej saj, e si shkak i kësaj ndodh sherri ndaj atij që e ka përhap këtë të keqe dhe ndaj të tjerëve.

Dhe a është përgojimi mëkat i vogël apo është nga mëkatet e mëdha?! Përkundrazi është nga mëkatet e mëdha.

Ibën Abdul-Kavij në vargjet e tij edDelijetul-Fik’hijetu ka thënë:

Dhe është thënë të vogla janë përgojimi dhe bartja e fjalëve –Kurse të dyja janë të mëdha sipas pohimit të Ahmedit

Ka për qëllim imam Ahmed ibën Hanbel, Allahu e mëshiroftë!

Pra, përgojimi është nga mëkatet e mëdha, Allahu i Plotfuqishëm thotë:

فَكَرَهُنْمُوهُ مَيْتًا أَخِيهِ لَحْمَ يَأْكُلُ أَنْ أَحَدَكُمْ أُحِبُّ بَعْضًا بَعْضُكُمْ يَغْتَبُ وَلَا

“...Mos e përgojoni njëri-tjetrin! Vallë, a dëshiron ndokush prej jush të hajë mishin e vëllait të vet të vdekur?! Sigurisht ju do ta urreni këtë!...”
(Huxhurat 12).

Kush dëshiron ta hajë mishin e vëllait të vet të vdekur, a ka dikush që e do këtë?! Askush nuk dëshiron që ta hajë mishin e vëllait të vet të vdekur. Allahu i Lartësuar e ka ngjasuar përgojimin me ngrënien e mishit të vdekurit, sepse ai që përgojohet nuk është i pranishëm që ta mbrojë vetën, ashtu sikur i vdekuri nëse ja ha mishin ai është i vdekur dhe nuk e mbron vetën.

Ky është ngjasim me diç me të shëmtuar që ka mundësi, gjë që aludon së përgojimi është i urryer tek Allahu i Plotfuqishëm, e po ashtu duhet të jetë e urryer edhe tek njeriu i mençur, sepse Allahu i Lartësuar thotë:

فَكْرَهُنَّوْهُ

“Sigurisht ju do ta urreni këtë!...” (Huxhurat 12).

Rreziku i përgojimit të dijetarëve:

Gjithashtu përgojimi i dijetarëve, kurse dijetarët pa dyshime që nuk janë të pa gabueshëm dhe askush nuk është i pa gabueshëm përveç një njeriut, e ai është i Dërguari i Allahut sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem, siç ka thënë imam Maliku, RahimehUllah: **“Nuk ka asnjë nga ne, përveç së i merret dhe i lihet fjala, me përjashtim të pronarit të këtij varri”** dhe bëri me shenjë kah varri i Pejgamberit sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem.

Dhe të vërtetën e ka thënë Allahu e mëshiroftë, çdo kush gabon, sa që njeriu e di gabimin e vet. Nganjëherë kur njeriu e thotë një fjalë, pastaj hulumton apo debaton në lidhje me të, i bëhet i qartë gabimi.

Mirëpo, a është nga mirënjohja ndaj dijetarëve, të cilët e kanë lodhur vetën në kërkimin e diturisë dhe nuk kanë kursyer asgjë në përhapjen e tij në mesin e Umetit, që kur të gabojnë ndonjë gjë, të përhapet gabimi i tyre dhe mos të përmenden të mirat e tyre? Përgjigja është: Jo, pasha Allahun!

Nuk është nga mirënjohja ndaj tyre dhe nuk është drejtësi e as korrektësi. Përkundrazi drejtësi është që të balancohen të mirat dhe të këqijat, e në qoftë së të mirat janë me shumë së të këqijat, atëherë njeriu është nga të mirët. Kjo ndodh kur të këqijat janë afër të mirave për nga numri. E si është halli kur është një e keqe karshi qindra të mirave?!

Mirëpo, disa njerëz Allahu na ruajttë një gabim të vetëm e merr shkak për të sharë, për thashetheme dhe i shton asaj të keqe shumë të këqija të tjera. Dhe kjo nuk lejohet kurrë në asnjë rast.

Dije që kur njerëzit e humbin besimin në dijetarë, nuk do të thotë kjo që i është bërë dëm dijetarit si individ, porse ky është dëmtim ndaj dijetarit dhe ndaj asaj që e bartë ai nga sheriatit. Kur dijetari bie nga pozita që e ka në sytë e njerëzve, ata nuk e pranojnë fjalën e tij edhe nëse është më e qartë së dielli.

Ngase besueshmëria është hequr prej tyre. Sikur mos të ishte besueshmëria e njerëzve në njeri tjetrin, kurrë nuk do të përfitonin prej njëri-tjetrit. Sa që njeriu me të cilin dëshiron të bësh një bashkëpunim, për t'i shitur dhe për të blerë prej tij, në qoftë se nuk i zë besë, a bashkëpunon me të? Jo!

Për këtë ju këshilloj që të jeni të kujdesshëm tej mase që të largoheni nga thashethemet, dhe të preokupohet njeriu me atë që i nevojitet e jo me atë që nuk i hynë në punë, sepse kjo është nga mirësia e Islamit të njeriu, ashtu siç ka thënë Pejgamberi sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem.

E lus Allahun e Lartësuar që të më bëj mua dhe juve nga ata që njerëzit nuk kanë sherr dhe të na ruaj nga sherri i tyre. Të na udhëzoj në rrugën e Tij të drejtë. Dhe të na i pranoj neve dhe juve **(punët e mira).**

Gjithashtu ju përgëzoj që prania e juaj në këtë ndej është brenda fjalës së Pejgamberit sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem: **“Kush merr rrugën për të kërkuar dituri, Allahu ja lehtëson rrugën për Xhenet.”**

Allahu na dhuroftë neve dhe juve sinqeritet!

Përktheu: Besim Gjelaj

Përktheu: Burim Mujaj

Përktheu: Xhemal Jakupi

Përktheu: Besmir Cacani